



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave Program i
Integruar i Nivelit të Dytë në “Farmaci”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Privat “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof As. Brunilda Myftari

2. Prof As. Rezarta Shkreli

Qershor/2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Program i Integruar i Nivelit të Dytë në “Farmaci” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Privat “Albanian University”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Farmacisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i shkencave (PI) në “Farmaci”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 226, datë 21.07.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR Nr. 4932/1 prot, datë 05.06.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 396, datë 28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 18, datë 02.03.2019
8	Cikli i studimit:	Niveli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite/ 10 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	26 PAE/ 16 PAK v.a. 2023-2024 23 PAE/ 18 PAK v.a. 2022-2023 18 PAE/ 19 PAK v.a. 2021-2022 22 PAE/ 21 PAK v.a. 2020-2021 24 PAE/ 23 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	68 Studentë v.a. 2023-2024 65 Studentë v.a. 2022-2023 65 Studentë v.a. 2021-2022 48 Studentë v.a. 2020-2021 40 Studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti privat "Albanian University" (AU), është institucion jopublik i arsimit të lartë, i hapur me Vendim Nr. 197, datë 10.04.2004 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "UFO dental". Po me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 597, datë 28.05.2009 emërtimi i shkollës së lartë universitare, private "UFO dental" ndryshon në "UFO University". Dy vite më vonë në 2011, institucioni merr emërtimin Universiteti Privat "Albanian University", emërtim të cilin e ka edhe sot.

AU sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij tre fakultete emërtuar si vijon:

- ✓ Fakulteti i Shkencave Mjekësore
- ✓ Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
- ✓ Fakulteti i Shkencave Shoqërore

Departamenti i Farmacisë, si pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, është njësi bazë përgjegjëse që ofron programin e studimit Master i Shkencave në "Farmaci", i cili u liçensua me vendim të MASH Nr. 5663 Prot., më datë 01/09/2005, si cikël studimi unik dhe i riorganizuar me Urdhër të Ministrit, Nr. 226, me datë 21.07.2009, si cikël studimi 5-vjeçar i integruar me 300 kredite (ECTS).

Programi i studimit është akredituar për herë të parë me Urdhër të Ministrit të MASH, Nr. 462, datë 14.10.2010 dhe riakredituar me VBA Nr. 18 datë 02.03.2019.

Ky program studimi është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit, ligjin 80/2015 për "Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve ligjore në fuqi për IAL dhe i referohet nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

Programi i studimit realizohet me 300 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 5 vite akademike (dhjetë semestra), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në "Farmaci".

Objektivi kryesor i këtij programi studimi është formimi i profesionistëve dhe specialistëve me aspektet teorike dhe praktike në fushën e farmaceutikës si në farmaci të rrjetit të hapur, në industrinë farmaceutike, si edhe në kërkimin shkencor në një fushë të caktuar.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm është bazuar në të dhënat, evidencat dhe informacionet e mbledhura nga njësia bazë, pjesë e njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit si dhe njësive administrative në mbështetje të tij. Këto të dhëna u mbledhën nëpërmjet metodave të ndryshme si dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e ASCAL, intervista dhe diskutime të zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë. Evidencat dhe RVB shërbyen si bazë për të përgatitur raportin e vlerësimit të jashtëm për Programin e Studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” dhe gjithashtu si evidencë mbështetëse.

Qëllimi i këtij raporti është të japë një vlerësim të pavarur mbi shkallën e përmbushjes së standarteve të cilësisë së Diplomave “Master i Shkencave” në “Farmaci”, që lëshon Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University. Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha kryesore vlerësimi:

- I. Ofrimi i programit të studimit
- II. Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të ciklit të dytë
- III. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat
- IV. Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit
- V. Studentët dhe mbështetja e tyre
- VI. Sigurimi i cilësisë së programit të studimit

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë vlerësohet në katër nivele:

- Përmbushet plotësisht
- Përmbushet kryesisht
- Përmbushet pjesërisht
- Nuk përmbushet

Procesi i vlerësimit është organizuar dhe koordinuar nga ASCAL nëpërmjet sistemit të menaxhimit AMS. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhej nga Prof.Asc. Brunilda MYFTARI, Prof.Asc. Rezarta SHKRELI, eksperte të jashtme, si dhe Z. Muhamed PREZJA, koordinator teknik, përfaqësues i ASCAL. Procesi u zhvillua me disa faza: Vlerësimi i brendshëm që u finalizua me hartimin dhe dorëzimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) së bashku me dokumentacionin mbështetës (DVB). Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Pas shqyrtimit të materialeve të vëna në dispozicion nga IAL, u zhvilluan vizitat në datat 29 dhe 30 tetor 2024 sipas një agjende të përpiluar dhe dakordësuar nga GVJ dhe ASCAL. Gjatë vizitës në institucion janë kryer takime me drejtues të njësisë kryesore dhe departamentit, me një pjesë të stafit akademik dhe studentëve, si dhe me disa njësi administrative mbështetëse të këtij programi. Këto takime sollën të dhëna shtesë dhe më të detajuara që ndihmuan në përpilimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) nga GVJ.

Në fund GVJ përfundon raportin duke nxjerrë në pah pikat e forta dhe të dobëta të këtij Programi Studimi dhe duke dhënë Rekomandimet përkatëse për plotësimin e standarteve dhe përmirësimin e cilësisë së Programit të Studimit “Master i Shkencave” (PI) në “Farmaci”.

Universiteti Privat “Albania University”, me datë 05.06.2025 dërgoi nëpërmjet sistemit AMS komentet në lidhje me draft raportin e punuar nga GVJ. GVJ, pasi shqyrtoi komentet dhe evidencat shtesë, në tërësi i qëndron mendimeve të saj përvec ndryshimit të vlerësimit final të fushës V.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.18, datë 02.03.2019 për Akreditimin Periodik të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Farmaci” janë:

- a. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik, me grada dhe tituj, me qëllim uljen e ngarkesës mësimore të stafit akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi.
- b. Institucioni të shohë mundësinë e rritjes së mbështetjes financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi në projekte kërkimore.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Grupi i ekspertëve të jashtëm pasi shqyrtoi me përgjegjshmëri dhe kujdes të gjitha materialet dhe komentet e bëra nga AU në lidhje me plotësimin e rekomandimeve të BA, konkludon se:

- a. Për rekomandimin e parë, institucioni ka bërë rekrutim stafi të brendshëm si dhe rishpërndarje të ngarkesës (duke shpallur dy herë në vit, në fillim të vitit akademik dhe përpara fillimit të semestrit të dytë, kërkesat për plotësim të stafit akademik me tituj dhe grada shkencore, sipas specifikave të çdo program studimi).
 - Bazuar në *Evidencën R1* mbi rekrutimet, rezulton se në Departamentin e Farmacisë janë rekrutuar vetëm 2 pedagogë, të cilët janë me MSc (2022-2023 semestri I dhe, 2023-2024 semestri II). Në 11 pedagogë të angazhuar rishtazi në programin e studimit (rekrutime 2019-2024) 6 janë në nivel MSc. Pra mund të thuhet se ka një përmirësim sasior, por nga pikëpamja cilësore e rekrutimeve të reja duhet bërë më shumë. Vlen të përmendet se gjatë viteve 2019-2024 PAE ka përparuar në marrjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë.
 - Gjatë periudhës akademike 2019-2024, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore është rekrutuar staf i ri akademik me kohë të plotë, gjë që ka reflektuar edhe në rishpërndarjen e ngarkesës mësimore për personelin akademik duke realizuar edhe plotësimin e standardit të kërkuar, ku *PAE mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore (konkretisht për vitin akademik 2023-2024 është 73.05/26.95), por në disa raste duke mos reflektuar në uljen e ngarkesës mësimore të personelit me kohë të plotë.*

Në përfundim nga sa u tha më sipër grupi i ekspertëve vlerëson që ky rekomandim është **përbushur kryesisht.**

b. Lidhur me rekomandimin e dytë, institucioni ka bërë përpjekje pozitive dhe ka marrë masa, konkretisht mbështetje financiare si më poshtë:

- Mbështetje financiare për botime në revista të indeksuara Scopus, Web of Science duke përfshirë pagesën e revistës apo edhe mbështetje financiare për autorët e parë dhe të dytë të stafit PAE/PAK të Departamentit të Farmacisë (*Evidencë shtesë 7*).
- Mbështetje financiare për botimet Monografi, për personelin akademik efektiv (*Evidencë R2*).
- Mbështetje financiare për personel akademik efektiv për studime të ciklit të tretë (PhD-Itali) (*Evidencë R2*).

Në përfundim nga sa u tha më sipër grupi i ekspertëve vlerëson që ky rekomandim është ***përmbyshur plotësisht.***

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave Program i Integruar i Nivelit të Dytë në “Farmaci”

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në Statutin e AU, Planit strategjik të institucionit dhe Rregulloren e AU, GVJ shprehet se Albanian University, Tiranë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Farmacisë ofron programin e integruar të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” prej 18 vitesh tashmë, duke kontribuar në formimin e profesionistëve të fushës farmaceutike në përputhje me interesat kombëtare, ruajtjen e konsolidimin e vlerave akademike në fushën e shëndetësisë. (Evidencë S I.1; Evidencë S I.2; S I.3)
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ, duke patur parasysh Rregulloren e FSHM dhe Rregulloren e Departamentit të Farmacisë si dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucion, vëren se Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit si dhe fushën e veprimtarisë. (Evidencë S I.4; S I.5)
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin e Albanian University, strategjinë dhe misionin e tij. Ky mision orientohet drejt krijimit, zhvillimit e transmetimit të dijeve në aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për t’u bërë ekspertë cilësorë të fushës së farmaceutikës, bazuar kjo në Statutin e AU, Rregulloren e Programit të studimit. (Evidencë S I.1; S II.1)
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës	Programi i studimit zhvillohet në përputhje me misionin e Albanian University dhe ka për qëllim jo vetëm të ofrojë njohuri dhe aftësi profesionale, por të përgatisë studentët dhe të diplomuarit me aftësi dhe kompetenca të thelluara që ndihmojnë në vijimin e studimeve të thelluara edhe në ciklin e tretë. Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” ofrohet me 300 ECTS, në 5 vite akademike.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

8

vendas dhe atë ndërkombëtar.	<i>(Evidencë S I.1; S II.1)</i>			
Konkluzione	Duke u bazuar në Statutin e Institucionit, Rregulloren e AU, Rregulloren e Programit të studimit dhe takimet në institucion GVJ vëren se ky program studimi ofrohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe interesin kombëtar. Nëpërmjet këtij Programi Studimi formohen specialistë në fushën farmaceutike si për farmacitë e rrjetit të hapur, por edhe për rrjetin spitalor, industrinë farmaceutike si dhe organet dhe autoritetet drejtuese e administrative të sektorit farmaceutik.			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Bazuar në të dhënat e RVB si dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe vetë Departamenti i Farmacisë ofrojnë këtë Program Studimi prej më shumë se 18 vjetësh, pra kanë mjaftueshëm përvojë në këtë drejtim. Po të shikojmë burimet njerëzore ato përmbushin standartin mbi raportin staf/student si nga ana akademike/ndihmës akademike dhe administrative (26 PAE, 16 PAK, 3 PNA për vitin akademik 2023-2024). Po kështu GVJ vëren se hapësirat në të cilat zhvillohet ky program studimi janë të mjaftueshme për numrin e studentëve që e ndjekin (5 m ² /student). <i>(Evidencë Anex Tab. nr.16)</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas	Duke u bazuar në RVB si dhe Evidencat mbështetse, të dorëzuara nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Albanian University", GVJ vëren se programi studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci" synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi praktike për tregun e punës në fushën e farmaceutikës. Fusha e këtij programi është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, të specifikuar në rregulloren e FSHM, si edhe me aktet rregullatore të institucionit, prioritetet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe gjithashtu në të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

9

direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	njëjtën linjë me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të vendit në fushën e shëndetësisë. Programi studimit është organizuar dhe klasifikuar sipas kornizës europiane/shqiptare të kualifikimeve dhe udhëzimeve të tjera kombëtare dhe europiane. <i>(Evidencë S I.2; S I.4; S II.1)</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	GVJ bazuar në RVB, konstaton se programi i studimit Master i Shkencave (PI) në “Farmaci” që ofrohet nga Departamenti i Farmacisë është në përputhje me profilin mjekësor të kësaj njësie kryesore dhe në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të këtij Departamenti. Gjatë vizitës u vu re se ka edhe përpjekje për të kryer kërkime shkencore të ndërthurura midis programeve të ndryshme të fushës së mjekësisë që ofrohen nga ky institucion, si p.sh.: bashkëpunime midis programit të studimit të Farmacisë dhe atij të stomatologjisë. <i>(Evidencë S I.2; S II.1)</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	N.A
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	“Albanian University” në bashkëpunim edhe me Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë si dhe IAL të tjera të specializuara në fushën e mjekësisë ka qënë pjesë e organizimit të konferencave shkencore dhe aktiviteteve të edukimit në vazhdim në drejtim të ngritjes profesionale të farmacistëve dhe jo vetëm. Shembuj organizimesh janë: Konferenca Kombëtare e Shkencave Mjekësore- 12 Maj 2024; Konferenca Mbarëkombëtare Farmaceutike VII “Së bashku për farmaceutikën”- Prill 2024, Kongresi Ndërkombëtar i Shkencave Mjekësore - 6 Nëntor 2023 etj. <i>(Evidencë S I.12; S II.10)</i>
Konkluzione	<i>Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekësore si njësi kryesore dhe Departamenti i Farmacisë si njësi bazë ofrojnë Programin e Studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” në përputhje me fushën e përgjithshme akademike të njësies kryesore</i>

	dhe bazë, specifikisht në atë farmaceutike, në përputhje me dispozitat dhe udhëzimet kombëtare dhe europiane. AU është pjesë aktive e bashkëpunimeve ndërinstitucionale në drejtim të ngritjes profesionale të farmacistëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Mjekësore pranë AU ka misionin kryesor formimin e profesionistëve të fushave të Stomatologjisë, Farmacisë, Infermierisë dhe Fizioterapisë. Duke patur një historik shumëvjeçar në ofrimin e këtyre programeve të studimit, e ka të konsoliduar tashmë organizimin dhe ndarjen e detyrave akademike dhe administrative në grupe pune, grupe kërkimore, etj. Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë specifike, njësia bazë dhe njësia kryesore për çdo vit akademik hartojnë raportin vjetor, i cili jep një analizë të detajuar të zhvillimit, organizimit dhe zbatimin e ligjshmërisë për programin e studimit dhe shprehet me plan masat përkatëse në pikat apo çështjet ku hasen vështirësi. <i>(Evidencë S III.1; S VI.12)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Bazuar në RVB, GVJ vëren se Albanian University në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit ka realizuar gjithashtu edhe një sërë bashkëpunimesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si me institucione publike ashtu dhe jopublike. Ndër më kryesoret përmendim: - Marrëveshje me IAL vendase dhe të huaja, të cilat ofrojnë programin e studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci" Universiteti i Padovës, Universiteti "Federico II" i Napolit etj. - Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë.

	GVJ vëren se të gjitha këto marrëveshje kanë impakt mjaft të rëndësishëm në ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit. (Evidencë S I.11)			
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale me subjekte farmaceutike. <i>Praktika profesionale zë një vend të konsiderueshëm në kurrikulën e programit, por në dokumentacionin shoqëruar GVJ nuk evidentoi një rregullore specifike për të.</i> <i>Përsa i përket mobilitetit të studentëve, GVJ konstaton se numri i studentëve që kishin përfituar nga marrëveshjet që mobilitetin e kishin pjesë të tyre ishte i ulët (7 studentë në 5 vite akademike, 2019-2024). E njëjta situatë paraqitej edhe përsa i përket mobilitetit të stafit akademik (8 personel akademik pranë Departamentit Farmacisë, gjatë periudhës 2019-2024).</i> (Evidencë shtesë 6)			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	GVJ konstaton se rezultatet e kërkimit në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera përfshihen në raportin vjetor të Departamentit të Farmacisë dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore. (Evidencë S III.1)			
Konkluzione	Në dritën e gjetjeve gjatë vizitës në institucion GVJ shprehet se Albanian University ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë vendase dhe të huaja, kompani dhe biznese farmaceutike, të cilat i shërbejnë realizimit të programit të studimit "Master i Shkencave" në Farmaci, aftësimi profesional të studentëve si dhe në funksion të kërkimit shkencor. Ndërsa në kuadër të mobilitetit të studentëve dhe të stafit akademik nuk është shfrytëzuar sa duhet kjo mundësi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master i Shkencave (PI) në “Farmaci” është organizuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015 si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”. Konkretisht, është organizuar në lëndë dhe module të shprehura në kredite (ECTS) dhe orë, me një total prej 60 kreditesh në një vit akademik dhe me kohëzgjatje 5 vjeçare (total 300 ECTS). Ngarkesa mësimore mesatare e studentit nuk tejkalon 25 orë në javë. Referuar dokumentacionit të paraqitur në RVB dhe atij shtesë, programi i studimit ofron një gamë të gjerë njohurish në kategorinë e lëndëve të formimit të përgjithshëm A (20 %), lëndëve karakterizuese profesionale B (53 %), integruese të fushës C (15 %), lëndë të aftësimit informatik dhe praktikës profesionale D (8%) dhe temës së diplomës E (4 %). <i>GVJ vlerëson se lëndë të tilla si Kimi Analitike i përket kategorisë së formimit të përgjithshëm, A, ndërsa lëndët Mikrobiologji dhe Sëmundje të Brendshme i përkasin kategorisë së lëndëve integruese, C duke reflektuar në ndryshimin e përqindjeve të krediteve për kategoritë A-E.</i> <i>Gjithashtu GVJ rekomandon që lënda Metodat e Kërkimit Shkencor të kategorizohet si lëndë e detyrueshme për çdo student dhe jo me zgjedhje, kjo për arsye se lënda shërben drejtpërdrejtë për përgatitjen dhe realizimin e temës së diplomës.</i> <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 9)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive	Programet e lëndëve janë hartuar me qëllimin që studenti të fitojë njohuri të thelluara dhe me gamë të gjerë në fushën farmaceutike

të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	si në aspektin e sintezës së barnave, kontrollit fiziko-kimik të formave farmaceutike, teknologjisë farmaceutike e kozmetike, përgatitjeve galenike, kimisë farmaceutike, farmakologjisë klinike, fitoterapisë, biofarmacisë dhe fushës së legjislacionit farmaceutik. <i>(Evidencë S II.5)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” Praktika Profesionale është parashikuar të përmbushë 16 ECTS dhe realizohet në bashkëpunim me farmacitë e rrjetit të hapur dhe aktorë të tjerë të biznesit farmaceutik në Shqipëri, nëpërmjet kontratës individuale për çdo student. Në kontratë specifikohen të drejtat dhe detyrimet e praktikantit, ngarkesa mësimore, orari dhe periudha e zhvillimit. Studenti është i detyruar të mbajë dhe të plotësojë librezën e praktikës profesionale, e cila pasi nënshkruhet nga drejtuesi i praktikës dhe dorëzohet në përfundim të saj tek pedagogu përgjegjës. Zhvillimi i praktikës profesionale monitorohet nga pedagogët përgjegjës të lëndës. <i>GVJ nuk evidentoi një rregullore/manual/procedurë specifike për praktikën profesionale.</i> Programi i studimit gjithashtu parashikon edhe zhvillimin e temës së diplomës në përfundim të studimeve me 12 ECTS, e cila zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të fundit të studimeve nën udhëheqjen e një pedagogu përgjegjës, në përputhje me rregulloren specifike. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën Master i Shkencave (PI) në programin e studimit “Farmaci”, të firmosur nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i Universitetit, e cila është dokument zyrtar. Modeli i diplomës është miratuar nga Senati Akademik dhe MAS.

	Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin/shtojcën e diplomës, sipas modelit të miratuar. <i>(Evidencë S III.4; S III.9)</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N.A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N.A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N.A

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në RVB si dhe në dokumentacionin e dorëzuar GVJ vëren se programi i studimit Master i Shkencave (PI) në “Farmaci” që ofrohet nga AU, FSHM, Departamenti i Farmacisë është një program DIND në të njëjtën fushë dhe me të njëjtën emërtesë me disa IAL të tjera në Shqipëri si me UMT me të cilin ka ngjashmëri në masën mbi 99%; me Universitetin ALDENT ngjashmëri më shumë se 96%, etj.			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është program i ciklit të dytë të studimeve, diplomë e integruar, kohëzgjatje normale 5 (pesë) vite akademike me kohë të plotë, në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015. Programi i studimit i përket nivelit të shtatë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), sipas Ligjit Nr. 10247 datë 04.03.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” dhe ka kodin përkatës sipas fushës së studimit. Kodifikimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Farmaci” program i integruar është bërë në përputhje me Udhëzimin nr.31, datë 15.11.2022 të MAS dhe rezulton 75MI0916S <i>(Evidencë S I.6; Evidencë Anex Tab. nr. 9)</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N.A			
Konkluzione	GVJ shprehet se programi i studimit në vija të përgjithshme organizohet bazuar në parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, por shpërndarja e lëndëve sipas kategorive nuk përmbush përqindjet e kërkuara dhe kërkohet vëmendje nga IAL-ja në lidhje me këtë aspekt.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

16

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Në bazë të të dhënave të paraqitura në RVB dhe dokumentacionin mbështetës, si dhe në gjetjet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbëhet nga 3 departamente, të cilët përmbushin kriteret ligjore. Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” ofrohet nga Departamenti i Farmacisë, pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, AU. Departamenti në 5 vitet e fundit përbëhet si më poshtë: - 2023-2024, 16 PAE (Prof. Dr. 1, Prof. As. 5, Dr. 1, Msc. 5) dhe 13 PAK (Prof. Dr. 4, Prof. As. 6, Dr. 3); - 2022-2023, 16 PAE (Prof. As. 5, Dr. 5, Msc. 6) dhe 15 PAK (Prof. Dr. 4, Prof. As. 5, Dr. 6); - 2021-2022, 15 PAE (Prof. As. 4, Dr. 6, Msc. 5) dhe 16 PAK (Prof. Dr. 2, Prof. As. 7, Dr. 5, Msc. 2); - 2020-2021, 18 PAE (Prof. As. 4, Dr. 8, Msc. 6) dhe 15 PAK (Prof. Dr. 4, Prof. As. 7, Dr. 3, Msc. 3); - 2019-2020, 18 PAE (Prof. As. 2, Dr. 9, Msc. 7) dhe 16 PAK (Prof. Dr. 4, Prof. As. 5, Dr. 3, Msc. 4); <i>(Evidencë S I.7; Evidenca Anex Tab. nr. 4; Tab. nr. 6.5)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	GVJ konstaton se Personeli Ndihmës/Akademik ka ardhur në rënie përgjatë 3 viteve të fundit nga 6 në 3 gjatë vitit akademik 2024-2025. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se kjo ka ardhur si pasojë e rënies së numrit të studentëve dhe uljes së numrit të grupeve të laboratorit dhe praktikave mësimore. <i>(Evidencë S I.7; Evidenca Anex Tab. nr. 4; Tab. nr. 6.5)</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë	Bazuar në RVB dhe gjetjet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Koordinatori i Programit, emërohet nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore me kërkesë të njësisë bazë në fillim të vitit akademik. Koordinatori i Programit të studimit përcjell shqetësimet e studentëve në lidhje me realizimin e programit mësimor në përputhje me planin e miratuar, respektimin

dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	e orarit të mësimdhënies nga personeli akademik, cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve, materialet didaktike etj. Ai informon vazhdimisht drejtuesin e Fakultetit qoftë nëpërmjet takimeve verbale apo në takime të tjera që realizohen gjatë vitit akademik. Përgjegjësi i Departamentit në mbledhjet e departamentit raporton në lidhje me ecurinë e programit, aspektet pozitive, problemet si edhe masat e marra për zgjidhjen e tyre. (Evidencë S I.9)			
Konkluzione	<i>Në përgjithësi Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti Farmacisë i përmbushin standartet ligjore me organizimin dhe strukturën e këtyre njësive. Numri i personelit akademik efektiv plotëson kërkesat e legjislacionit në fuqi. Numri i personelit ndihmës akademik në nivel njësie bazë është i mjaftueshëm duke marrë në konsideratë numrin e studentëve në programin e studimit. Koordinator i caktuar është përgjegjës për ecurinë e programit të studimit dhe praktikat profesionale që ofron Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Duke qënë se Programi Studimit të ofruar është Msc, diplome DIND, GVJ sugjeron që IAL të angazhohet edhe për përmbushjen e kriterit të gradës shkencore, që duhet të ketë personeli akademik që jep mësim në një program të tillë studimi, bazuar në Standartet e Cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në RVB, dokumentacionin mbështetës dhe gjetjet gjatë vizitës në Institucion, GVJ vëren se Departamenti i Farmacisë si njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit, disponon dokumentacionin për programin e studimit; të dhëna të përgjithshme për programin, objektivat formuese, synimet, kriteret përzgjedhëse; regjistrimet, transferimet, tarifat, metodat e mësimdhënies etj.; rregulloren e programit; planin mësimor; syllabuset e lëndëve si dhe ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese; CV ^{te} e personelit akademik.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

18




	<i>(Evidencë S I.5; S II.1; S II.4; S II.5; S IV.1; Evidenca Anex Tab. nr. 13, nr 23, etj)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Në bazë të RVB dhe evidencave në dispozicion GJV vëren se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” përmban planin mësimor, ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët e parashikuara në auditor/jashtë auditorit. Plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” përmban informacion në lidhje me ngarkesën mësimore sipas semestrave, orët në auditor dhe jashtë auditorit, të ndara në orë leksioni dhe orë seminari, laborator, praktike etj. Programi studimit zgjat pesë vite akademike: për çdo semestër janë parashikuar orët në auditor dhe orët jashtë auditorit që në totalin vjetor janë 1500 orë. Gjatë vitit të pestë akademik, studenti realizon praktikën profesionale mësimore me 400 orë mësimore (352 orë në auditor/48 orë punë e pavarur), 16 kredite gjithsej si edhe punon për realizimin e temës së diplomës me 300 orë mësimore gjithsej/ 12 kredite. Në përmbajtjen lëndore, syllabuset, janë përcaktuar qartë klasifikimet e tyre me kredite sipas tipologjisë së përcaktuar në VKM nr. 41 (kategoria A, B, C, D dhe E). Referuar dokumentacionit shoqërues të RVB dhe atij shtesë plani mësimor aktual nuk ka ndryshime ndaj planit mësimor të riakreditimit të fundit, viti 2019. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 10, S II.5)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në bazë të evidencave të paraqitura gjatë procedurës së aplikimit nga Institucioni dhe gjetjeve gjatë vizitës në Institucion GJV konstaton se ka një procedurë për pranimin e studentëve në programin e studimit të përfshirë në Rregulloren e Universitetit, Fakultetit dhe Rregulloren e programit të studimit. Theksojmë se në këtë program studimi ka ardhur në ulje numri i aplikantëve nga viti në vit me rreth 50 studentë mesatarisht në vitin akademik 2024-2025 me një mesatare pranimi, në përputhje me VKM e vitit përkatës akademik. Ndërkohë, çdo vit akademik me propozim të Fakultetit, Senati Akademik i AU miraton kriteret specifike të pranimit në programin e studimit për vitin pasardhës. Këto kritere bëhen publike dhe dërgohen në MAS dhe QSHA për t’u njohur nga maturantët. Regjistrimi dhe transferimi i studimeve rregullohen me akte të përvitshme nga MAS dhe institucioni ka kryer transferimet e

	studimeve, procedurat e transferimit, si dhe ekuivalentimi i programeve të studimeve për studentët që transferohen. Ka një rregullore specifike për pranimet dhe transferimet. Rregullorja e universitetit parashikon rastet dhe sasinë e krediteve përkatëse që njihen. <i>(Evidencë S I.3; S I.4; S I.5; S II.1; S II.4)</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	GVJ konstaton se në planet mësimore përfshihet informacioni i nevojshëm me karakter informativ dhe praktik, në përputhje me kurrikulën e programit të studimit. Në planin mësimor të programit të studimit dhe në syllabuset e lëndëve paraqiten të dhëna të detajuara mbi emërtimin e moduleve të grupuara dhe të renditura në semestra; numrin e krediteve për çdo modul dhe raporti i orëve (leksione, seminare, laboratorë); detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, punime, detyra kursi, projekte, praktikë); mënyrat e kontrollit të dijeve të çdo moduli. <i>(Evidencë S II.5)</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Gjatë vizitës në Institucion si GVB dhe Personeli Akademik deklaruan se plani mësimor rishikohet në fillim të çdo viti akademik nga njësia bazë dhe forma finale miratohet në senat për t'u zbatuar në vitin akademik në vijim. Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulën, kursin dhe semestrin kur zhvillohet, karakterin e modulit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literaturën. <i>(Evidencë S II.5; S II.6; S II.7)</i>			
Konkluzione	<i>Nga sa u tha më lart GVJ shprehet se Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci" i ofruar nga AU është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese si program i integruar i nivelit të dytë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

20

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i integruar i studimit është emërtuar Master i Shkencave (PI) në “Farmaci” në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe i përket ciklit të dytë të studimeve, me kohëzgjatje 5-vjeçare si program i integruar (DIND). Elementët përbërës janë shpërndarë në mënyrë të tillë që studentët jo vetëm të aftësohen me njohuri të thellë profesionale, por edhe të kenë njohuri dhe kompetenca për të vazhduar ciklin e tretë të studimeve siç janë studimet e doktoratave. GVJ vëren se në lidhje me raportin teori/praktikë, orët laboratorike dhe praktikat profesionale të studentëve zënë 49% të programit përkundrajt 51% teori. (Evidencë Anex Tab. nr.13)
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Ngarkesa mësimore e programit të studimit është e ndarë në orë në auditor dhe orë jashtë auditorit, ku 39 % të orëve e zënë orët e leksioneve. Në zbatim të sistemit të Bolonjës ku 1 ECTS është ekuivalent me 25 orë, prej tyre një pjesë realizohen në auditor dhe një pjesë jashtë auditorit, raport që ndryshon në varësi të tipit të veprimtarisë mësimore të zhvilluar. Mesatarisht në një vit akademik janë parashikuar 3391,5 orë totale, ku 51 % të tyre janë orë laborator dhe ngarkesa mesatare javore e studentit luhet 20 - 25 orë, në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Ngarkesa mësimore javore shpërndahet në mënyrë të harmonizuar në orë 50 minutëshe gjatë ditëve të javës në leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika. Gjithashtu, njësia bazë në përputhje me udhëzimet në fuqi realizon ndarjen e kurseve të studentëve në grupe leksioni, seminari dhe laborator përshtatur edhe me kapacitetet e infrastrukturës së sallave mësimore dhe laboratorëve. (Evidencë Anex Tab. nr.10, Evidencë S II.5)
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në	GVJ duke shqyrtuar në detaje programin e studimit në dispozicion, vihet re një raport teori/praktikë teorike 51% kundrejt 49% laboratorike dhe praktikat mjekësore gjë që duhet përmirësuar më tej për t’u bërë i ngjashëm me programet e tjera studimore të të njëjtës fushë si dhe disa programe ndërkombëtare. Pika 2.5 e VKM 41 viti 2018 përcakton qartë veprimtaritë formuese, të cilat janë të pasqyruara në planin mësimor. Natyra e moduleve të

rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një modul. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 10)</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ shprehet se bazuar në RVB dhe të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në institucion, ndarja në module e lëndëve mundëson mobilitetin e studentëve, i cili megjithatë nuk është në nivele të mira. Nga ana tjetër kjo ndarje jep mundësi për transferimin e studimeve. Në këtë aspekt GVJ vlerëson se duhet të përmendet fakti që një sërë studentësh të diplomuar nga ky program studimi kanë ekuivalentuar diplomën e tyre në shtete të ndryshme perëndimore, Kanada etj. <i>(Evidencë shitesë 6; Evidencë S II.4; Evidenca shitesë 11)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Bazuar në RVB, GVJ vëren se syllabuset e programit të studimit përmbajnë të gjitha elementet sipas përcaktimeve të VKM nr. 41, Dt. 24.01.2018: pika 2.8 duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënës, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura e detyruar dhe ajo e këshilluar. GVJ vëren se këto elemente janë respektuar. <i>(Evidencë S II.5, Evidencë Anex Tab. nr. 14)</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Bazuar në RVB dhe gjetjet gjatë takimeve në institucion, GVJ konstaton se raporti optimal i veprimtarive formuese çon drejt plotësimit të objektivave formues, duke diplomuar studentë të aftë për tregun e punës ($\geq 80\%$ të punësuar në përputhje me diplomën), edhe të aftë për të vazhduar studimet e ciklit të tretë. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 23, Evidencë S II.1)</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ bazuar në RVB dhe evidencat e kërkuara gjatë takimeve dhe të paraqitura nga institucioni vëren se mbi 80% e studentëve janë të punësuar që në vitin e parë pas diplomimit në profesion. Kjo tregon që përgatiten specialistë të fushës farmaceutike të vlefshëm për tregun e punës. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 23)</i>

Konkluzione	Përgjithësisht, përmbajtja e programit të studimit mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, shpërndarja e lëndëve dhe orëve në auditor është bërë e balancuar mes semestrave. Programi studimit përmban lëndë nga disiplina të ndryshme të cilat plotësojnë objektivat e punësimit në farmaci rrjeti hapur, industri farmaceutike, pozicione rregullatore në sektorin farmaceutik etj. Ngarkesa mësimore totale për një kredit është e njëjtë për të gjitha lëndët. Rezultatet e punësimit të të diplomuarve në katër vitet akademike është mesatarisht mbi 80%.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Bazuar në RVB, GVJ shprehet se Departamenti i Farmacisë si njësi përgjegjëse për programin e studimit "Master i Shkencave" në Farmaci konsultohet vazhdimisht, jo vetëm me aktorët kryesorë brenda institucionit, por edhe me ata jashtë tij, për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Ndër strukturat pjesë e Albanian University në përmirësimin e programit të studimit marrin pjesë jo vetëm Departamenti, por po ashtu edhe Dekani, Zyra për Zhvillimin e Kurrikulave, NJSBC, Komisioni i Kurrikulave e deri tek Senati Akademik. <i>Në kuadër të përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit, GVJ sugjeron përfshirjen më të gjërë të të dhënave nga studimi tregut të punës.</i> <i>(Evidencë S II.6; S II.10)</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur	Bazuar në RVB si dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se studentët në programin e studimit, të cilët duke qenë në kontakt me stafin akademik për një kohë të gjatë prej 5 vitesh japin mendimin dhe propozimin e tyre për programin e studimit. Ata janë të organizuar me përfaqësuesit e tyre "senator" në nivel kursi, por edhe në nivel programi studimi, edhe në Senatin Akademik që është edhe hallka më e lartë e miratimit të planeve mësimore, ku njëri prej anëtarëve është përfaqësues nga studentët.

ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	<i>Alumni, të cilët janë në kontakt me departamentin në kuadër të aktiviteteve me subjektet farmaceutike dhe të edukimit në vazhdim, duhet të përfshihen më shumë në reflektimin e eksperiencës së tyre në drejtim të përmirësimit të kurrikulës së programit të studimit.</i> <i>(Evidencë S V.4)</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Bazuar në RVB si dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se në përmirësimin e programit të studimit ndikojnë edhe struktura të tjera si: - Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë; - Qendra e Edukimit në Vazhdim. Organizimi i konferencave të ndryshme shkencore apo studentore në bashkëpunim me UFSH apo edhe IAL të tjera në fushën shëndetësore kontribuojnë gjithashtu në përmirësimin e programit. <i>(Evidencë S II.10)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ mund të shprehet se Albanian University nxit zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta me institucione profesionale dhe IAL homologe në shërbim jo vetëm të edukimit në vazhdim por edhe të tthithjes së sygjërimeve për përmirësimin e programit mësimor. Po kështu përfaqësimi i studentëve deri në nivel Senati u jep atyre mundësinë të kontribuojnë në këtë drejtim, por mungojnë evidencat përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Bazuar në të dhënat nga RVB si dhe ato të grumbulluara gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se për sa i përket prioritetëve dhe objektivave të studimit dhe kërkimit shkencor, ato janë përcaktuar qartë në Programin e studimit “Master i Shkencave” në Farmaci në përputhje me ato të institucionit në përgjithësi. <i>(Evidencë S II.12)</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

24




Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Bazuar në RVB si dhe sic u shprehën anëtarët, Koordinatorja dhe Përgjegjësjë e Departamentit gjatë takimeve specifike në Institucion, njësia bazë në bashkëpunim të ngushtë me atë kryesore organizon, bashkërendon dhe monitoron zhvillimin e mësimdhënies dhe aktiviteteve të tjera mbështetëse apo kërkimore-shkencore në respekt të lirisë akademike të secilit pjesëtar të stafit akademik. Në këtë drejtim është krijuar edhe Bërthama e Kërkimit Shkencor në nivel Departamenti, <i>por ende nuk ka rezultate të kënaqshme në fitimin e projekteve të kërkimit shkencor.</i> <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 19, 22)</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Pjesëmarrja e studentëve në aktivitete studimore, kërkimore evidentohet me punimin e temave të diplomave eksperimentale apo teorike, në prezantimin e tyre në konferencat studentore të organizuara nga KKSHM e UMT, apo edhe në konferencën vjetore të UFSH. <i>Duhet bërë më shumë për pjesëmarrjen e studentëve në projekte kombëtare e ndërkombëtare.</i> <i>(Evidencë S II.10, Evidencë Anex Tab. nr. 22)</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Në RVB theksohet se ka një mbështetje financiare nga institucioni për njësinë bazë, <i>por duke marrë në konsideratë buxhetin e vitit 2023, që na është sjellë si evidencë mbas vizitës së GVJ, kjo mbështetje është minimale. Kështu që GVJ vëren se për këtë qëllim duhet që institucioni të rrisë mbështetjen e tij.</i> <i>(Evidencë shtesë 3)</i>			
Konkluzione	<i>Në dritën e të dhënave të mësipërme GVJ shprehet se Programi i studimit është i orientuar në fushën farmaceutike, në përputhje me misionin e AU. Angazhimi i studentëve në punë kërkimore bazohet tek temat e diplomave kryesisht dhe referimi i tyre në konferenca të ndryshme vendase. Duhet bërë më shumë për motivimin e studentëve që të marrin pjesë në projekte ndërkombëtare p.sh.: Erasmus+ etj. Mbështetja financiare e Personelit Akademik dhe aq më tepër e studentëve në kërkime shkencore duhet rritur.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

25

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Bazuar në RVB si dhe siç u shprehën pedagogët, Koordinatorja dhe Përgjegjësjë e Departamentit gjatë takimeve specifike në Institucion, njësia bazë në bashkëpunim të ngushtë me njësinë kryesore organizon, bashkërendon dhe monitoron zhvillimin e projekteve kërkimore-shkencore dhe për këtë qëllim është krijuar edhe Bërthama e Kërkimit Shkencor në nivel Departamenti, <i>por ende nuk ka rezultate të kënaqshme në fitimin e projekteve të kërkimit shkencor.</i> Ka patur edhe disa bashkëpunime për shkrimin e projekteve të përbashkëta me njësi bazë të FSHM ose nga fakultete të tjera të AU për të rritur suksesin e këtyre aplikimeve. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 19, 20)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	GVJ vëren se në bazë të RVB dhe të gjetjeve në institucion në Departamentin e Farmacisë ka një predispozitë për të kryer analiza, studime e për të aplikuar për projekte të ndryshme. Nga pikëpamja logjistike disponohen hapësirat e nevojshme laboratorike dhe një sërë pajisjesh të nevojshme si HPLC, GC, Spectrophotometër, të cilat me sa u deklarua shërbejnë edhe për punimin e temave eksperimentale në kuadër të diplomimit të studentëve. <i>(Evidencë S II.13)</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Bazuar në RVB njësia përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Farmaci" pranë AU bashkëpunon me KKSHM e UMT për Konferencën studentore si edhe me UFSH për Konferencën përkatëse. Në to marrin pjesë me referimet e tyre student dhe personel akademik duke bërë më vizibël për komunitetin mjekësor në përgjithësi dhe atë farmaceutik në veçanti rezultatet e tyre të kërkimit shkencor. Studentët nxiten të marrin pjesë në aktivitete si Einter School dhe Summer School të organizuara nga organizata Brainstorm. <i>(Evidencë S II.10)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Bazuar në RVB mund të thuhet se programi i studimit ka një kombinim të mirë të lëndëve bazë me ato profesionale si dhe parashikon një periudhë praktike profesionale çka nënkupton formimin e profesionistëve të aftë për tregun kombëtar të punës dhe më gjerë. Punësimi në masën mbi 80% të të diplomuarve në përputhje me diplomën është një evidencë domethënëse.

	<i>(Evidencë Anex Tab. nr. 23)</i>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Profesionisti Farmacist pasi ka marrë diplomën universitare duhet të kalojë testin VAP pranë UFSH dhe Provimin e Shtetit për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit. Bazuar në të dhënat e parashtruara në RVB dhe evidencat mbështetëse GVJ vëren se AU bashkëpunon me UFSH për të patur të dhëna të sakta mbi rezultatet e të diplomuarve në Provimin VAP (Vlerësim i Aftësive Praktike) dhe duke vlerësuar nevojën e ndonjë përmirësimi të mundshëm në kurrikul. Nuk ka evidencë konkrete. GVJ nuk gjen ndonjë evidencë mbi rezultatet e këtyre studentëve në Provimin e Shtetit, QSHA.			
	<i>(Evidencë Anex Tab. nr. 23)</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Bazuar në RVB dhe gjetjet në institucion gjatë vizitës atje, GVJ vëren se programi i studimit Master i Shkencave (PI) në “Farmaci” është organizuar dhe zhvillohet në përputhje me aktet ligjore në vend mbi profesionet e rregulluara, ku bën pjesë edhe farmacisti, si dhe direktivat e rregulloret ndërkombëtare, si: • Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. • Ligji Nr. 05/L-066 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”. • Directive 2005/36/EC of the European Parliament and of the Council of 7 September 2005 on the recognition of professional qualifications.			
Konkluzione	GVJ shprehet se programi i studimit përmban njohuri të thelluara në fushën farmaceutike, si edhe krijon mundësi kërkimi shkencor të suksesshëm, por duhet bërë më shumë për ndërkombëtarizimin, për pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel departamenti si edhe për rritjen e numrit të studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

27

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në RVB dhe specifikisht në Syllabuset e paraqitura GVJ vëren se format e mësimdhënies, mësimnxënies janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit dhe praktikat profesionale. (<i>Evidencë Annex Tab. nr. 15</i>)
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Bazuar në RVB, si dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në Programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është i brezave të ndryshëm çka rezulton në kombinimin e metodave tradicionale me metodat më të reja. Në kuadrin e testimeve aplikohen metoda të ndryshme si ato me zhvillim dhe ato me alternativa. Në kuadrin e mësimdhënies e mësimnxënies përdoren edhe metodat interaktive të të mësuarit. (<i>Evidencë Annex Tab. nr. 8; Evidencë S III.2</i>)
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Bazuar në RVB si dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vëren se platform TEAMS e ofruar nga institucioni gjatë periudhës së COVID-19 ka rezultuar e suksesshme si nga pikëpamja e pedagogëve ashtu edhe nga ajo e studentëve. Kështu që tashmë është transformuar në një platform ku ngarkohen leksione e materiale të tjera didaktike, literatura mbështetëse dhe mund të përdoret nga studentët në kuadrin e mësimnxënies. Po kështu prania e projektorëve dhe internetit në shumë prej auditoreve konsiderohet një mbështetje për personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. (<i>Evidencë Anex Tab. nr.17</i>)

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

28

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Bazuar në RVB si dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ mund të shprehet se megjithëse në pjesën më të madhe, personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, ka raste kur duhet të mbulojë edhe lëndë larg këtyre kompetencave. Ka pedagogë që përdorin metoda interaktive të mësimdhënies. Funksionimi i sistemit të Tutoriatit vlerësohet nga studentët si një mënyrë, që u siguron atyre mbështetje dhe mundësinë e ndërtimit të marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. <i>(Evidencë S II.5)</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Bazuar në RVB dhe takimet në Institucion si dhe vizitën në ambjentet e zhvillimit të mësimi GVJ konstaton se zhvillimi i mësimi bëhet në grupe të vogla duke u dhënë mundësinë të gjithë studentëve që të marrin pjesë aktive në mësim. Nga ana tjetër zhvillimi i pyetësorëve me studentët dy herë në vit bën të mundur grumbullimin e mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve e më pas reflektimin e tyre në ndryshimet përkatëse. Këto raste përfshihen në Raportin vjetor të Departamentit të Farmacisë. <i>(Evidencë S II.9; S III.1)</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht	Bazuar në RVB dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se është ngritur dhe funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi në bashkëpunim me njësinë kryesore organizon dhe bashkërendon aktivitete për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Këtë e realizon nëpërmjet pyetësorëve, por edhe me formularët e vlerësimit të performancës së pedagogëve dhe stafit ndihmës. Organizon pyetësorë anonim si me studentët edhe me stafin dhe të dhënat përpunohen dhe përfundimet e arritura përfshihen në raportet e vjetore sipas niveleve përkatëse. Në bazë të këtyre rezultateve merren masa për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, zhvillimin e metodave të reja dhe në përputhje me to, trajnimin e personelit akademik. <i>(Evidencë S VI.1; Evidencë S III.2)</i>

personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.				
Konkluzione	GVJ vëren se Institucioni siguron mbështetje logjistike të mjaftueshme për të zhvilluar metoda të avancuara të mësimdhënies e mësimnxënies duke nxitur përfshirjen sa më të gjerë të studentëve. AU vazhdimisht organizon aktivitete me fokus trajnimin e stafit akademik mbi metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, aspekteve sociale në marrëdhëniet me studentët, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Bazuar në RVB si dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ vlerëson se mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit dhe procedura të posaçme. Ato i'u bëhen të ditura studentëve si nëpërmjet Tutorëve, por edhe nga vetë pedagogët e lëndëve. Nga takimi me studentët u vu re se ata ishin të mirëinformuar në lidhje me to. (Evidencë S II.1)
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ vëren se në bazë të RVB dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, qoftë gjatë takimit me stafin akademik qoftë gjatë takimit me studentët rezulton se Departamenti i Farmacisë e ka praktikë, që në fillim të çdo lënde/moduli studentët të informohen nga pedagogu përkatës mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. (Evidencë: Vizita në institucion- Takim me stafin akademik, studentët, Minutat në institucion)
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	GVJ vëren se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore i studentëve të Programit të studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

30

profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Master i Shkencave në “Farmaci” realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme si me pyetje me alternativa, po ashtu edhe me zhvillim. Po ashtu studenti ka mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara edhe gjatë vitit akademik me vlerësime të ndërmjetme, detyra kursi etj. Këto aktivitete vlerësohen me një numër të caktuar pikësh që student i mbart para zhvillimit të testit përfundimtar. Teza përfundimtare përpilohet nga titullari/lektori i lëndës dhe miratohet edhe nga Përgjegjësi i Departamentit.			
	<i>(Evidencë S II.1; S II.5)</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se në dritën e vlerësimeve të mësipërme rezulton se institucioni është transparent me studentët në lidhje me mënyrën e vlerësimit dhe testimin të njohurive të tyre. Gjithashtu studentët janë të qartë për procedurën e vlerësimit qysh në fillim të lëndës, gjë që i shpjegohet nga Titullari/Lektori përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në të dhënat e RVB si dhe nga gjetjet gjatë takimeve në Institucion GVJ vëren se testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit duke u vlerësuar në pikë nëpërmjet seminareve, projekteve ose testimeve të ndërmjetme, të cilat janë të përcaktuara në syllabusin e lëndës dhe bëhen pjesë e vlerësimit përfundimtar të studentit. Në çdo syllabus është e shkruar mënyra e vlerësimit të studentit dhe gjithashtu pedagogët përkatës ua bëjnë me dije studentëve që në orën e parë mësimore.
	<i>(Evidencë S II.1; S II.5)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimin dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sistemet elektronike janë përdorur gjatë periudhës së pandemisë COVID -19 për disa lëndë (statistikë, psikologji etj), ndërsa tani Platformat on-line si: Office 365 -Microsoft Teams etj. përdoren për aktivitete të ndryshme në kuadrin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, por jo të testimin.
	<i>(Evidencë Anex Tab. nr.17)</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

31

Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Gjatë takimit me pedagogë dhe studentë gjatë takimeve në institucion GVJ i'u konfirmua se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në mënyrë të unifikuar sipas rregullores dhe syllabuseve të përgatitura për çdo lëndë: deri në 40 % e vlerësimit realizohet nga detyrat dhe anazhimi/aktivizimi i studentit gjatë procesit mësimor dhe deri në 60% e vlerësimit nga provimi përfundimtar. <i>(Evidencë Anex Tab. nr.15)</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Bazuar në të dhënat e RVB si dhe nga gjetjet gjatë takimeve në Institucion GVJ vëren se në varësi të nivelit të vlerësimit të njohurive të arritura, studenti merr edhe feed-back nga pedagogët, anëtarë të komisionit të provimit, në formën e komenteve dhe këshillave me gojë, për rezultate më të larta në të ardhmen. <i>(Evidencë: Vizita në institucion- Takim me stafin akademik dhe studentët)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në RVB, GVJ shprehet se Departamenti i Farmacisë organizon provimet në salla të tilla që të mundësohet distanca midis studentëve për pamundësimin e kopjimit, ndalohen mjetet elektronike të komunikimit si dhe mbikëqyren nga 2 pedagogë. Ky institucion ka një pajisje për kontrollin antiplagjaturë. <i>(Evidencë S II.1; S III.3)</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në të dhënat e RVB, GVJ vëren se afati i dhënies së rezultateve të provimeve studentëve është 5 ditë. Ato jepen individualisht për secilin prej tyre nga Komisioni i provimit dhe bazohen në meritë. Më pas hidhen në sistemin online "Pitagora" nga lektori i lëndës, ku secili student njihet me rezultatin e tij. <i>(Evidencë S I.4; S II.1)</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Bazuar në të dhënat e RVB si dhe nga gjetjet gjatë takimeve në Institucion GVJ vëren se Studenti pasi njihet me vlerësimin, ka të drejtë që të rishikojë fletën ose edhe ta ankimojë vlerësimin me shkrim. Ankesa i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit, i cili mbasi e shqyrton ngre një komision të posaçëm për të rimarrë studentin në provim. <i>(Evidencë S I.4; S II.1)</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga	Bazuar në të dhënat e RVB si dhe nga gjetjet gjatë takimeve në Institucion GVJ vëren se Komisioni i provimit merr parasysh çdo

komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	kërkesë apo ankimim dhe nëse nuk zgjidhet, atëherë e merr në shqyrtim Komisioni i posaçëm. Procedura është tërësisht transparente dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës. (Evidencë S I.4; S II.1; S III.3)			
Konkluzione	Bazuar në sa më sipër GVJ shprehet se Institucioni zbaton metoda të drejta, transparente në vlerësimin e secilit student sipas meritës. Institucioni vë në dispozicion, sallat, pajisjet, komisionet nga të paktën 2 pedagogë për arritjen e këtij qëllimi, por testimi elektronik duhet aplikuar edhe në lëndë të tjera për shmangien e abuzivizmit të mundshëm dhe rritjen e transparencës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	GVJ vëren se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” që ofrohet nga Departamenti i Farmacisë, FSHM pranë Albanian University, garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale e shkencore të tyre. Kjo kurrikulë është organizuar në 5 vite akademike dhe ka 35 lëndë ku studenti thellon njohuritë në disa drejtime kryesore të fushës farmaceutike. Plani strategjik institucional dhe rregullorja e programit të studimit përcaktojnë si mision të programit të studimit: • Të krijojë, transmetojë dhe zhvillojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj studentëve. • Të përgatisë specialistë të lartë në fushën e farmaceutikës për t’u përshtatur me kërkesat e kohës dhe të tregut të punës. • Të kontribuojë në rritjen e standarteve të cilësisë në fushën e mësimdhënies, të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e brezit të ri si pjesë integrale e një shoqërie të tillë. (Evidencë S I.2; S II.1)

Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Bazuar në RVB dhe dokumentat shoqëruese të dorëzuara nga Institucioni në sistem, mund të thuhet se programi përmban edhe lëndë të tilla si statistika, informatika, psikologjia, etikë e deontologji, gjuhë e huaj, etj., që ndikojnë në zhvillimin e aftësive të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, shkencave sociale dhe humane si dhe gjuhën e huaj. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 10)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimet e zhvilluara në Institucion GVJ vëren se në javën e fundit të lëndës studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final, nëse do jenë me zhvillim, me alternativa apo e kombinuar. Gjithashtu iu bëhet sërish e qartë studentëve, edhe pesha që do të ketë në notën finale të modulit, provimi final. <i>(Evidencë: Vizita në institucion- Takim me stafin akademik)</i> <i>(Evidencë 77 dhe 78- Syllabus Pharmacy 1, syllabus pharmacy 2)</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Bazuar në RVB si dhe nga gjetjet gjatë takimeve në institucion GVJ vëren se mësimdhënia realizohet e tillë që t'u japë studentëve kompetencat e duhura teorike në mënyrë që ata të zhvillojnë me sukses seancat praktike. Laboratorët zhvillohen në grupe të vogla prej 2-3 studentësh. Në seancat e seminareve pedagogët nxisin diskutimet në grup për zgjidhjen e problemeve të caktuara. Gjithashtu në disa raste ndërthuren mësimdhënia edhe me institucione bashkëpunuese duke mundësuar kështu edhe mobilitetin e studentëve. <i>(Evidencë: Vizita në institucion- Takim me stafin akademik dhe studentët)</i> <i>Dokument 18 Minutat në Institucion (Farmaci)</i>

Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Bazuar në RVB si dhe nga gjetjet gjatë takimeve në institucion u konstatua se disa nga pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm zhvillojnë orë të hapura mbi të reja të shkencës, sidomos me studentët e viteve të fundit. si p.sh: • E. M. - Metodatat e avancuara të Kërkimit Shkencor (Dhjetor 2021) • D. Xh – Përgatitja e temës së diplomës për punime të Kërkimit Shkencor dhe Epidemiologjike (Shkurt 2020) <i>Rekomandohet shtimi i mëtejshëm i tematikave dhe numrit të leksioneve të hapura.</i> <i>(Evidencë S III.5)</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Bazuar në RVB, GVJ vëren se Albanian University nxit zhvillimin e ideve innovative nga studentët dhe i mbështet ata për prezantimin e punëve kërkimore në Konferenca të ndryshme si ato të organizuara në bashkëpunim me UFSH, UMT etj. <i>Nuk ka evidencë për mbështetje financiare të studentëve Master i Shkencave në “Farmaci”.</i> <i>(Evidencë Anex Tab. nr.22)</i>			
Konkluzione	Bazuar në sa më sipër GVJ shprehet se Programi i Studimit Master i Shkencave në “Farmaci” garanton pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara shkencore, teoriko-praktike dhe nxit iniciativat për kërkim shkencor të studentëve nën udhëheqjen e pedagogëve duke i prezantuar ato edhe në konferenca të ndryshme me karakter profesional e shkencor, por nuk evidentohet një mbështetje financiare e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për	Bazuar në RVB, GVJ konstaton se AU ka një procedurë të caktuar për realizimin e temës së diplomës si detyrim përmbyllës për çdo




detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	student të programit të studimit “Master i Shkencave” në Farmaci. Ajo zhvillohet në vitin e 5-të të studimeve dhe studentët janë të njohur me këto detaje në afatet e duhura kohore. <i>(Evidencë S III.4)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Në procedurën për zhvillimin e temës së diplomës janë të përcaktuar pedagogët udhëheqës të caktuar nga Departamenti, temat e përzgjedhura, ndjekja e procesit të punës për zhvillimin e mikrotezës. Gjatë gjithë kohës së përcaktuar për zhvillimin e temës së diplomës studenti mbështetet jo vetëm nga vetë udhëheqësi, por edhe struktura të tjera me materiale mbështetëse, udhëzime, këshilla, pajisje, reagentë e salla në dispozicion nëse puna është eksperimentale, deri në përfundim të saj. <i>(Evidencë S III.7)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në RVB, GVJ konstaton se Komisioni i posaçëm për vlerësimin final bazohet në: ➤ mënyrën e prezantimit, ➤ mënyrën e shkrimit të temës, ➤ rezultatet përgjatë gjithë ciklit 5-vjeçar ➤ vlerësimin e udhëheqësit shkencor. <i>(Evidencë S II.1)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Bazuar në RVB, GVJ vëren se Departamenti i Farmacisë përcakton paraprakisht udhëheqësit e diplomave dhe këta të fundit orientojnë dhe ndihmojnë diplomantët e tyre në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi mbështet, ndjek dhe monitoron studentin gjatë gjithë punës së tij si dhe në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesit të miratuar. Ai miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit të posaçëm. Gjithashtu udhëheqësi i diplomës është përgjegjës së bashku me studentin në rast kopjimi a plagjature. <i>(Evidencë S III.4)</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në	Bazuar në RVB, mund të thuhet se AU vë në dispozicion të diplomantëve literaturë të shkruar dhe online në platformat Microsoft TEAMS, Sharepoint, Forms, pa limit dhe EBSCO,

mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	ERIC, Cambridge Journals, etj., me 1 vit kontratë me të drejtë rinovimi. Studentët mund t'i përdorin këto platforma për hulumtime në kuadër të punimit të diplomës. Nëse tema është eksperimentale, AU u vë në dispozicion laboratorët, pajisjet, reagentët. Nga ana tjetër AU asiston studentët nëpërmjet pedagogëve udhëheqës për kryerjen e punimeve në fusha të ndryshme studimi sipas ekspertizës përkatëse. <i>(Evidencë S II.1; Evidencë Anex Tab. nr.17)</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar në RVB, GVJ vëren se studenti në përfundim të mbrojtjes së diplomës dorëzon Prezantimin në PPT si dhe hardcopy dhe vlerësohet nga komisioni i posaçëm me notë. Notat pasqyrohen qartë në proces-verbalin e posaçëm. <i>(Evidencë S III.4)</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në RVB, GVJ vëren se në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përkatëse e arsimit. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. <i>(Evidencë S III.3; S III.9)</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në RVB, GVJ konstaton se është Departamenti i Farmacisë, njësia që ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. <i>(Evidencë S III.9)</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në sa më sipër GVJ shprehet AU ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master i Shkencave në "Farmaci" dhe e përgatit atë me</i>

	dokumentacionin e nevojshëm. Këto procedura u komunikohen studentëve përmes personelit akademik dhe administrativ. Manuali i hartimit të temës së diplomës shpjegon qartazi gjithë etapat që çdo student duhet të ndjekë për realizimin me sukses të temës së diplomës. AU ruan dokumentacionin sipas legjislacionit në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	NA
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	NA
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e	NA

trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	-			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	-	-	-	-

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Referuar dokumentacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, si edhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që personeli akademik (PAE/PAK) i angazhuar gjatë pesë viteve akademike në realizimin e programit studimor “Master i Shkencave” në “Farmaci” përmbush kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik për mbulimin e lëndëve, dhe është si më poshtë: 1. Për vitin akademik 2019-2020 në këtë program studimi janë angazhuar gjithsej 47 pedagogë, nga të cilët 24 janë Personel Akademik Efektiv (PAE), nga ku 4 janë Prof. Asoc, 11 Dr. dhe 9 Msc, dhe 23 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK), nga ku 4 janë Prof. Dr., 9 Prof. Asoc., 5 Dr. dhe 5 Msc. (51.1%/48.9%). 2. Për vitin akademik 2020-2021, në këtë program studimi janë angazhuar gjithsej 43, nga të cilët 22 janë Personel Akademik Efektiv (PAE), nga ku 5 janë Prof. Asoc, 12 Dr. dhe 5 Msc, dhe 21 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK), nga ku 3 janë Prof. Dr., 10 Prof. Asoc., 5 Dr. dhe 3 Msc. (51.2%/48.8%).

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

39

	3. Për vitin akademik 2021-2022, në këtë program studimi janë angazhuar gjithsej 37, nga të cilët 18 janë Personel Akademik Efektiv (PAE), nga ku 1 Prof. Dr., 4 janë Prof. Asoc, 8 Dr. dhe 5 Msc, dhe 19 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK), nga ku 3 janë Prof. Dr., 8 Prof. Asoc., 7 Dr. dhe 1 Msc. (48.7%/51.3%). 4. Për vitin akademik 2022-2023, në këtë program studimi janë angazhuar gjithsej 41, nga të cilët 23 janë Personel Akademik Efektiv (PAE), nga ku 1 Prof. Dr., 6 janë Prof. Asoc, 7 Dr. dhe 9 Msc, dhe 18 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK), nga ku 4 janë Prof. Dr., 10 Prof. Asoc. dhe 4 Dr. (56.1%/43.9%). 5. Për vitin akademik 2023-2024, në këtë program studimi janë angazhuar gjithsej 42, nga të cilët 26 janë Personel Akademik Efektiv (PAE), nga ku 3 Prof. Dr., 5 janë Prof. Asoc, 10 Dr. dhe 8 Msc, dhe 16 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK), nga ku 4 janë Prof. Dr., 9 Prof. Asoc. dhe 3 Dr. (61.9%/38.1%). Përgjatë pesë viteve akademike 2019-2024 vërehet qëndrueshmëri e stafit akademik efektiv, faktor i cili reflektohet në produkt akademik dhe shkencor cilësor dhe përmirësim të vazhdueshëm të standarteve të cilësisë. Referuar përcaktimeve ligjore (pika 6, neni 59, Ligji Arsimit Lartë dhe Kërkimin Shkencor Nr. 80/2015) personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës; nga sa më sipër konstatohet që stafi akademik i angazhuar në realizimin e procesit mësimor është i kategorive Profesor, Doktor i Shkencave dhe Msc. <i>Me qëllim përmbushjen e kërkesave ligjore në fuqi lidhur me nivelin e duhur të kualifikimit të personelit akademik, GVJ sugjeron marrjen e masave të nevojshme për të mundësuar që si personeli efektiv dhe ai me kontratë i angazhuar në programin studimor të ketë minimalisht gradën shkencore, doktor.</i> Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ kërkoi informacion shtesë rreth normativës së ngarkesës mësimore të stafit akademik të angazhuar në programin studimor dhe mori
--	---

	konfirmimin që në raste të veçanta kjo normativë rregullohet me vendime të brendshme institucionale. <i>GVJ sugjeron që institucioni të marra masa në vazhdimësi për përmbushjen e detyrimit që titullari apo lektori i lëndës të ketë fushën e ekspertizës apo kërkimit shkencor në përputhje me natyrën dhe veçoritë e lëndëve të ofruara.</i> <i>(Evidencë Anex Tab. Nr. 6, 7, 8, Evidencë S II.5; S IV.1)</i>																														
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik efektiv në këtë program studimi është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi duke plotësuar normativat e kërkuara nga Ligji Arsimit Lartë, me qëllim realizimin e mësimdhënies në institucionet arsimit lartë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, tabelave përmbledhëse të programit dhe të departamentit përgjegjës për programin, u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për pesë vitet akademike është si më poshtë: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2019-2020</td><td>4555</td><td>3175.5</td><td>1379.5</td><td>69.7 %/ 30.3 %</td></tr><tr><td>2020-2021</td><td>4357</td><td>3112.5</td><td>1184.5</td><td>72.4 % /27.6 %</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>4273</td><td>3012.5</td><td>1260</td><td>70.5% /29.5 %</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>4440</td><td>3112.5</td><td>1327.5</td><td>70.5% / 29.5%</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>4981</td><td>3638</td><td>1342</td><td>73% / 27%</td></tr></table> Personeli akademik efektiv i angazhuar në realizimin e programit studimor mbulon mbi 70% te ngarkesës totale mësimore. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 12)</i>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2019-2020	4555	3175.5	1379.5	69.7 %/ 30.3 %	2020-2021	4357	3112.5	1184.5	72.4 % /27.6 %	2021-2022	4273	3012.5	1260	70.5% /29.5 %	2022-2023	4440	3112.5	1327.5	70.5% / 29.5%	2023-2024	4981	3638	1342	73% / 27%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																											
2019-2020	4555	3175.5	1379.5	69.7 %/ 30.3 %																											
2020-2021	4357	3112.5	1184.5	72.4 % /27.6 %																											
2021-2022	4273	3012.5	1260	70.5% /29.5 %																											
2022-2023	4440	3112.5	1327.5	70.5% / 29.5%																											
2023-2024	4981	3638	1342	73% / 27%																											
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si edhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” që ofrohet nga Departamenti Farmacisë. Kontratat e punësimit pranë AU dhe mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetsore janë realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.																														

sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	<i>(Evidencë S II.2; S II.3; Evidencë Anex Tab. nr. 2)</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e DVV, faqen web të IAL si edhe dokumentacionit shtesë të kërkuar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se procedurat e rekrutimit të stafit akademik i referohen kuadrit ligjor të AU. Në statutin e AU (neni 40) dhe rregulloren institucionale (neni 30) janë të përcaktuara kriteret e përgjithshme të punësimit të personelit akademik si edhe kriteret dhe procedurat e rekrutimit. - Në fillim të çdo viti akademik, bazuar në nevojat për personel akademik, departamenti Farmacisë i paraqet Dekanit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore kërkesat për plotësimin e vendeve vakante. - Dekani i përcjell kërkesat Rektoratit, i cili miraton kërkesën dhe kriteret e pranimit, propozuar nga njësia bazë. - Për të realizuar procedurën e rekrutimit ngrihet një komision ad hoc pranë njësisë kryesore. - Pas shqyrtimit të kandidaturave të propozuara nga Komisioni Vlerësimit, Rektori miraton kandidatët e përzgjedhur duke i dhënë përparësi kandidatit që plotëson më mirë kriteret pranimit. - Kandidati i përzgjedhur nënshkruan kontratën e punës me Rektoren. <i>Në dritën e dokumentacionit të deklaruar nga vetë IAL, GVJ sugjeron zgjerimin e kriterëve specifike, e cila do të garantonte përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për fushën përkatëse.</i> <i>(Evidencë S I.1; S I.3; S II.2; S II.3; Evidencë shtesë 10)</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ, bazuar në vizitën në institucion konstaton përshtatshmërinë e mjediseve dhe infrastrukturës në dispozicion për mbarëvajtjen e programit studimor. Informacioni i paraqitur në RVB paraqet angazhimin e 3 personave në pozicionin e stafit ndihmës-akademik, një numër ky i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike mësimore duke marrë në konsideratë edhe numrin e grupeve të studentëve si edhe për mirëmbajtjen e laboratoreve dhe mjediseve të tjera mësimore. Gjatë vizitës së zhvilluar në institucion GVJ evidenton përshtatshmërinë e stafit ndihmës-akademik që zotërojnë diplomën

	'Master i Shkencave' si edhe disponueshmërinë e tyre në menaxhimin dhe realizimin me sukses të orëve laboratorike. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 2)</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik efektiv, me kontratë dhe atij ndihmës-akademik, në AU, është Zyra e Burimeve Njerëzore. Gjatë vizitës pranë kësaj strukture, GJV konstatoi se Zyra e Burimeve Njerëzore mban të dhëna në formën e dosjeve personale (hard copy) për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit. Nga verifikimi me zgjedhje në mënyrë të rastësishme i 4 dosjeve, përkatësisht 2 PAE dhe 2 PAK, GJV konstatoi plotësinë e tyre lidhur me: kontratë individuale/aneks kontratë, raport mjekoligjor, diplomat dhe lista e notave shoqëruese, CV personale, leje nga punëdhënësi (personeli PAK) etj. <i>Në dosje mungonte dokumenti i emërimit nga Rektori, për personelin me kohë të plotë.</i> Informacioni lidhur me kërkesën individuale të personelit akademik sipas lëndëve dhe semestrave mbahej nga departamenti përgjegjës për programin e studimit. <i>(Evidencë S I.1; S I.3)</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	AU në nivel institucional ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione publike dhe private, si edhe biznese farmaci rrjeti hapur, në funksion të realizimit të procesit mësimor dhe atij kërkimor shkencor. Programi studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci" ka pjesë të kurrikulës zhvillimin e praktikës profesionale gjatë semestrit dytë, vitit të pestë. Departamenti Farmacisë cakton personel akademik përgjegjës për mbarëvajtjen e studentit gjatë praktikës mësimore. Gjithashtu, personeli mbikëqyrës në farmacinë pritëse, drejtuesi Teknik, angazhohet dhe kontribuon në aftësimin profesional të studentit praktikant, ndihmon në plotësimin e saktë të librezës personale të praktikës mësimore të tij, si një raport përfundimtar i firmosur nga Drejtuesi Teknik.
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e	

praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Kjo përbën dokumentin bazë konfirmues të kryerjes së praktikës profesionale mësimore, e cila vlerësohet me notë nga komisioni i miratuar i provimit. Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga komisioni i ngritur në department. <i>(Evidencë S I.12; S IV.2; S III.1)</i>			
Konkluzione	<i>Personeli akademik dhe ai ndihmës-akademik që angazhohet në këtë program studimi plotësojnë kushtet e kërkuara për nivelin e duhur profesional. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga IAL në disa raste vërehet mospërputhje mes profilit të lektorit apo titullarit lëndës me natyrën dhe specifikat e modulit që ata mbulojnë. Institucioni ndjek procedurat e duhura të rekrutimit të personelit akademik duke përcaktuar kritere të përgjithshme, por sugjerohet shtimi i kritereve specifike në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij program studimi. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi mundëson zhvillimin e praktikës mësimore profesionale, duke u siguruar që mbikëqyrësi, Drejtuesi Teknik në vendin e praktikës, të angazhohet në rritjen e nivelit profesional të studentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, si edhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në AU, GVJ konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” zhvillon procesin mësimor në një mjedis me infrastrukturë të përshtatshme, me ambiente të mjaftueshme për të zhvilluar veprimtaritë mësimore të këtij programi studimi, duke marrë në konsideratë kurrikulën e programit dhe numrin e studentëve. Infrastruktura në funksion të procesit mësimor në AU përfshin sallat e leksioneve, seminareve, laboratoreve mësimore, zyra për

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

44

	stafin, biblioteka, si edhe hapësira të jashtme. Institucioni, gjithashtu disponon sistem ngrohje-ftohje qëndrore, sistem sigurimi, nyje hidrosanitare të mjaftueshme, sistem të mbrojtjes kundra zjarrit etj. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 16)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi disa ambiente mësimore, si: salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjedise të tjera ku vuri re që mjediset, sipas funksionit të tyre ishin të përshtatshme dhe komode për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe kërkimor-shkencor si për studentët ashtu edhe për personelin akademik. Sallat leksioneve/seminareve ishin të pajisura me kompjutera, projektorë dhe lidhje internet, si dhe kishin ndriçim dhe ajrosje optimale për kryerjen e aktivitetit mësimor. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 16)</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Referuar planit mësimor, GVJ konstaton se programi studimor “Master i Shkencave” në “Farmaci” ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar ku edhe parashikon realizimin e orëve laboratorike, të detyrueshme në masën 100%. Pranë AU, në funksion të programit të studimit janë laboratorët: - Laborator Kimisë Analitike - Laborator Teknologjisë Farmaceutike - Laborator Kimisë Përgjithshme Inorganike - Laborator Kimisë Farmaceutike - Laborator Farmakognozisë - Laborator Kimisë Toksikologjike - Laborator Anatomisë - Laborator Fizikës Laboratorët janë të pajisur me të gjithë aparaturat, pajisjet apo mjetet mësimore, reagentët dhe lëndët para. Këta laboratorë shfrytëzohen nga studentët e programit studimor për njohjen dhe aftësimin praktik të të gjitha njohurive teorike të fituara përgjatë pesë viteve akademike, në disiplina të formimit të përgjithshëm dhe atij profesional, si edhe për realizimin e detyrave të kursit, temës së diplomës etj. Gjithashtu këto ambiente janë të dispozicion edhe për realizimin e kërkimit shkencor apo projekteve konkrete nga ana e stafit akademik, me përfshirjen e studentëve.

	(Evidencë S II.13)			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, AU ka një laborator të informatikës të pajisur me kompjutera dhe akses në programe dhe databaza specifike si të statistikës SPSS dhe kërkimit të literaturës në dispozicion të studentëve dhe stafit. (Evidencë Anex Tab. nr. 16)			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Për realizimin e praktikës profesionale, AU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucioni dhe njësie kryesore me subjekte private të sektorit farmaceutik të rrjetit të hapur, të cilat u mundësojnë realizimin e praktikave profesionale studentëve të këtij programi studimi. Praktika profesionale zhvillohet në vitin e pestë, me shkëputje nga procesi mësimor, në mjediset e subjektit pritës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të miratuar dhe firmosur nga palët. (Evidencë S I.10; S II.1)			
Konkluzione	Duke iu referuar numrit aktual të studentëve të programit studimor, mjediset e AU janë të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor. Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Farmaci" ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar dhe parashikon realizimin e orëve të detyrueshme laboratorike. Praktika profesionale e studentëve të këtij program studimor realizohet në mjediset e subjekteve pritëse, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur mes palëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në ambjentet e AU, GVJ konstaton se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve të këtij programi studimor, që zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe, përgjithësisht garanton marrjen e dijeve dhe njohurive sipas parashikimeve në lëndët e programit të studimit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se syllabuset lëndore përmbanin literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, ku pjesë e literaturës bazë ishin tekste mësimore me autorë vendas dhe të huaj apo edhe përmbledhje leksionesh të përgatitura nga vetë pedagogu lëndës. Gjithashtu GVJ evidentoi që përpara fillimit të vitit akademik Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës në bashkëpunim me njësitë bazë në AU realizon rishikimin dhe përditësimin e përmbajtjeve lëndore/syllabuseve për vitin e ri akademik. Në Raportin Vjetor mbi Veprimtarinë e Departamentit Farmacisë për vitin akademik 2022-2023, në pikën Mësimdhënia dhe Studentët u evidentua raportimi specifik lidhur me përpjekjet e vazhdueshme të stafit akademik për përditësimin e literaturës bazë me botime cilësore dhe të viteve të fundit. <i>(Evidencë S II.5; S II.7; S II.8; S III.1)</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	AU vë në dispozicion të të gjithë studentëve të regjistruar në këtë program studimor bibliotekën në katin parë të godinës në Rugën e Durrësit, Mjediset e ish-Gjykatës dhe një sallë leximi me 20 poste të pajisur me kompjutera dhe internet pa limit. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëloj nga të gjithë studentët dhe personeli AU, kundrejt një anëtarësimi pa pagesë. Nga vizita në këtë bibliotekë, si dhe informacioni paraqitur në RVB, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimor, si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe, materiale dhe tekste në gjuhë të huaj (libra periodikë, revista dhe botime të tjera). Literatura gjendet në formatin tradicional (kopje fizike, letër), si edhe në formën elektronike CD dhe DVD.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista	

shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Shërbimi i bibliotekës “on line” ofrohej nëpërmjet platformës EBSCO (https://www.ebsco.com) me të drejtë rinovimi dhe Eric (https://emagasinpdf.com) open access. GVJ konstatoi se Biblioteka dispononte kopje të librave që rekomandohen në literaturën e programit të studimit. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 17; S II.8; S IV.3)</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Shfrytëzimi i bibliotekës fizike dhe online është i garantuar në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët dhe stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në ambjentet e bibliotekës, GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur me kompjutera që mund të përdoren nga studentët për të shfrytëzuar literaturën e bibliotekës në formatin elektronik (CD dhe DVD), bibliotekën on line nëpërmjet platformave elektronike si edhe për të hulumtuar në internet në funksion të realizimit të detyrave të kursit dhe temës së diplomës.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Shërbimi i bibliotekës ofrohet dhe vihet në dispozicion për studentët vetëm në oraret e zhvillimit të procesit mësimor, duke marrë në konsideratë kërkesat dhe nevojat e tyre brenda një orari të kufizuar. <i>GVJ sugjeron që akses i studentëve në bibliotekë të zgjerohet edhe në orare të tjera përtej atij mësimor, në fundjavë apo edhe përgjatë sesionit të provimeve.</i> <i>(Evidencë S III.7)</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të	Referuar RVB, njësia bazë, Departamenti Farmacisë, monitoron dhe ndjek vazhdimisht cilësinë e programit fizik dhe asaj on line të bibliotekës, përditëson dhe monitoron shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe atij on line nga personeli akademik dhe studentët, si edhe merr masat e duhura për realizimin e pasurimit të vazhdueshëm të fondit referuar sugjerimeve të stafit akademik apo edhe studentëve të cilët paraqesin nevojën për ndonjë literaturë specifike. <i>Në dokumentacionin shoqërues të RVB nuk u vu re ndonjë zë raportimi specifik financiar lidhur me përditësimin e fondit fizik të literaturës me botime të viteve të fundit.</i>

studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Gjithsesi, regjistrimi në disa platforma elektronike (biblioteka online) ofron mundësinë për përditësim literature digjitale për studentët. (Evidencë S III.7; Evidencë Anex Tab. nr. 18)			
Konkluzione	Institucioni vë në dispozicion të studentëve literaturë bazë dhe ndihmëse, për të gjitha lëndët e kurrikulës, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse realizohet nëpërmjet një procedure specifike ku stafi akademik i angazhuar në programin studimor sugjeron tituj librash, artikujsh, revistash në gjuhë shqipe apo të huaj, me të rejat më të fundit shkencore. Biblioteka fizike dhe online vihet në dispozicion të të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor për këtë program studimi. Ambjenti i bibliotekës ka internet dhe është i pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike dhe platforma për bibliotekën online. GVJ sugjeron që aksesin në bibliotekë të zgjerohet edhe në orare të tjera përtej atij mësimor, në fundjavë apo edhe përgjatë sesionit të provimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se institucioni përdor sistemin tradicional të administrimit të informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin akademik të tyre nëpërmjet dokumentacionit në formatin letër dhe elektronik, përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm PITAGORA. Nëpërmjet këtij sistemi, sekretaria mësimore e AU administron të gjithë historikun e ecursisë akademike të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, të cilin e ruan në dosje përkatëse në arkivën e AU. Studentët disponojnë portalin e dedikuar për ta nëpërmjet të cilit marrin informacionin e nevojshëm për të gjithë programin studimor.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

49

	Koordinimi i të dhënave mes sekretarisë mësimore, stafit akademik dhe studentëve realizohet përmes dy platformave elektronike PITAGORA dhe TEAMS ku ata kanë akses të caktuar ndaj marrjes së informacionit. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 17)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore në formën e dosjes personale të personelit, ndërsa informacioni lidhur me aktivitetin mësimor dhe shkencor të personelit akademik administrohet nga njësi bazë përgjegjëse për programin studimor (ngarkesa mësimore, syllabuset, aktiviteti shkencor i tyre etj). Sistemi menaxhimit të studentëve TEAMS dhe PITAGORA lehtëson ruajtjen e informacionit dhe dokumentacionit në funksion të veprimtarisë akademike dhe administrative. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 17)</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sikurse u përmend edhe më sipër, sistemi i menaxhimit të informacionit është i organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 17)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ konstaton se institucioni ka vendosur në dispozicion platforma on line të mësimin në distancë, si: Office 365-Microsoft Teams, me një afat kohor të palimituar, e cila ju vjen në ndihmë stafit akademik dhe studentëve për një komunikim interaktiv dhe inovator përmes teknologjisë së informacionit. Përmes kësaj platforme pedagogët dhe studentët publikojnë materiale bazë dhe shtesë të leksioneve, linqe dhe video ilustruese, projekte dhe detyra kursi sipas afateve të paracaktuara etj. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 17)</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson	GVJ konstaton se në tërësi sistemi menaxhimit AU bëhet në mënyrë të dokumentuar duke respektuar aktet rregullatore të institucionit dhe garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrative të institucionit si edhe mundëson evidentimin në

raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Pas konsultimit të website të AU, GVJ konstaton se informacioni lidhur me programin studimit, personelin akademik si edhe një sërë informacionesh të tjera apo aktivitete shtesë janë publike dhe publikohen të përditësuara në faqen zyrtare të internetin në gjuhën shqip dhe anglisht. <i>Referencë: https://albanianuniversity.edu.al</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon sistem menaxhimi efektiv nëpërmjet të cilit administron informacionin lidhur me studentët nga momenti regjistrimit e deri në diplomim, në programin studimor. Sistemi menaxhimit ka të integruar platforma që mundësojnë komunikim interaktiv me studentët si edhe shkëmbim informacioni në funksion të një procesi mësimdhënës-mësimnxënës cilësor. Informacionet rreth programit studimor janë të aksesueshme lehtësisht në ëbsite të IAL, në gjuhën shqip dhe anglisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare përbën një komponentë të rëndësishëm, i cili garanton mbarëvajtjen e procesit mësimor si edhe qëndrueshmërinë e programit të studimit. Referuar Statutit të AU, GVJ konstaton se Bordi Administrimit të AU miraton një plan buxhetor afatmesëm tre vjeçar dhe një plan buxhetor vjetor për vitin pasardhës kalendarik. Gjithashtu kjo strukturë miraton edhe raportin e veprimtarisë financiare të hartuar nga bashkëpunimi i zyrës së financës dhe rektorati së bashku me strukturat nënvarësi të tij.

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani financimit institucional përmban financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, qera ambjenti, kontratat e shërbimeve të sigurisë etj. <i>Në dokumentacionin plotësues, GVJ konstaton raport financiar institucional, por jo specifik për programin studimit në farmaci.</i> <i>(Evidencë S I.1; S III.1)</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Referuar statutit të AU dhe Rregullores së Funksionimit të Zyrës së Financës dhe Auditit të Brendshëm, institucioni kontrollon dhe auditohet nga Njësia e Auditit të Brendshëm pranë Zyrës së Financës, ndërsa kontrolli dhe auditimi i jashtëm në AU kryhet nga auditues të jashtëm financiar, ku miratohet pozicioni financiar dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve të krijuara. Raporti auditit të jashtëm fokusohet në kërkesat ligjore në fuqi.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ mbështetur në dokumentet shoqëruese të RVB konstatoi se AU harton raportin financiar të kostove të njësive bazë për programet e studimit që ofron ky institucion duke evidentuar realizimin e projekt buxhetit të miratuar të vitit akademik paraardhës. Në përfundim të vitit akademik, njësitë bazë dhe ato kryesore informohen mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe marrin masa për planifikimin e buxhetit të vitit akademik pasardhës. <i>(Evidencë S I.1; https://albanianuniversity.edu.al)</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë	Referuar RVB dhe dokumenteve shoqëruese, GVJ konstaton se të ardhurat e AU janë të klasifikuara sipas burimeve të parashikuara

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

52

financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësishë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	të financimit: të ardhura nga tarifat për dhe gjatë shkollimit si edhe të ardhura nga projektet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (për vitin akademik 2023-2024). Sigurimi i të ardhurave për institucionin përmes fondeve jopublike në vitin e fundit akademik është një hap pozitiv, i cili rrit jo vetëm cilësinë e programit studimor, por është gjithashtu edhe një tregues i stabilitetit financiar afatmesëm dhe afatgjatë, në këtë kontekst GVJ sugjeron zgjerimin e mëtejshëm të burimeve të të ardhurave si: projektet, sponsorizime, shërbime të kualifikimit të vazhdueshëm, konsulenca apo shërbime ndaj të tretëve. (Evidencë Anex Tab. nr. 18)			
Konkluzione	Referuar statutit, AU auditohet nga njësi e auditimit brendshëm dhe nga kompani auditimi të jashtëm, ku miratohet situata financiare dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve financiare. GVJ sugjeron zgjerimin e mëtejshëm të burimeve të të ardhurave si projekte, sponsorizime apo shërbime ndaj të tretëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion si edhe nga faqja web e AU, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.
	(Evidencë S I.1; S I.3; S I.4; S I.5; S II.1)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

53

fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në rregulloren e programit studimit specifikohet që pranohen në këtë program studimi kandidatët të cilët kanë përfunduar maturën shtetërore, shkollën e mesme (të përgjithshme apo profilizuar, sistemi vjetër) apo shkollën e mesme profesionale 5 vjeçare dhe plotësojnë kriteret pranimit të IAL-së ku aplikojnë. Kriteret e vendosura nga IAL rishikohen çdo vit me qëllim rritjen e cilësisë së studentëve në hyrje të programit dhe në përfundim të ciklit të dytë të studimit në programin e integruar “Master i Shkencave” në “Farmaci”, në të cilin çdo student fiton 300 ECTS. AU nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek garanton barazi për të gjithë kandidatët për student, në të gjitha programet e ofruara. <i>(Evidencë S II.1; S V.1)</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstaton se pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet e ciklit parë dhe të ciklit dytë të integruar realizohet në përputhje me kriteret pranimit dhe përzgjedhjes të propozuara nga departamenti që ofron programin e studimit dhe që më pas miratohen me vendim Senati Akademik, para fillimit të vitit akademik. Kriteret e aplikimit dhe udhëzimet përkatëse për procedurën e aplikimit bëhen publike në faqen web të AU. Sekretaria Mësimore, Zyra e Këshillimit Karrierës dhe Koordinatori Programit Studimit asistojnë nëpërmjet informimit të drejtpërdrejtë të kandidatëve të interesuar në mjediset institucionale. <i>(Evidencë S II.1; S V.2; S V.3)</i> <i>(https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit)</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë	Pas shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues të RVB si edhe pas konsultimit të faqes web të AU, GVJ konstaton se kriteret, procedurat pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, procedurave të transferimit, njohjes së plotë ose të pjesshme të studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme nga publiku nëpërmjet faqes zyrtare web të IAL, në rregulloren e programit të studimit apo nëpërmjet informimit të drejtpërdrejtë në mjediset institucionale.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

54




lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriter i përgjithshëm i pranimit në programet e ciklit parë dhe ciklit dytë të integruar është nota mesatare e shkollës mesme, përcaktuar me VKM nr. 436 dt. 3.6.2020. Kandidati për student duhet të ketë përfunduar arsimin e mesëm brenda ose jashtë vendit, me kushtin që ky i fundit të ketë të njehsuar diplomën e shkollës së mesme nga MAS. <i>(Evidencë S II.1; S V.2; S V.3)</i> <i>(https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit)</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Informimi i të gjithë të interesuarve në lidhje me AU, programet e studimit dhe kriteret e pranimit në to, realizohet nëpërmjet faqes web të AU apo përmes publikimeve në ambjentet e universitetit. Kriteret e pranimit janë të paraqitura në rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin studimit, si edhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit. <i>GVJ konstaton se kuadri rregullator i AU nuk ka parashikime specifike për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, por respekton kuadrin ligjor në fuqi dhe Udhëzimet e MAS.</i> <i>(Evidencë S I.1; S I.3; S I.4; S I.5; S II.1)</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	NA
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	NA
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni parashikon procedurë financiare lehtësuese (Statuti AU, neni 77) për kandidatët me aftësi të veçanta apo të shtresave të marginalizuara (komuniteti rom dhe egjiptian, familje në nevojë, studentë me aftësi të kufizuar etj). Gjithashtu me qëllim rritjen e veprimtarisë mësimore të studentëve si edhe krijimin e shembujve dhe modeleve të punës së mirë, AU parashikon në statutin e tij reduktim të tarifës së shkollimit për studentët që janë pjesë e programit të ekselencës (Statuti AU, neni 76). Informacioni mbi bursat gjendet i përditësuar në faqen web të AU. Për periudhën akademike 2019-2024, numri i studentëve që kanë përfituar reduktim të tarifës së studimit janë: ● 6 studentë, burse ekselence

	• 17 studentë, 50% zbritje burse • 169 studentë, 30% zbritje burse <i>(Evidencë S I.1)</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/			
Konkluzione	<i>AU nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek garanton barazi për të gjithë kandidatët për student, në të gjitha programet e ofruara. Kriteret e aplikimit dhe udhëzimet përkatëse për procedurën e aplikimit bëhen publike në faqen web të AU. Institucioni parashikon procedura financiare lehtësuese për kandidatët me aftësi të veçanta apo të shtresave të margjinizuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurave të përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, GVJ konstaton se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e e përparimit akademik të tyre si edhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve dhe moduleve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Këto kriteret dhe procedura janë pjesë e Rregullores AU, Rregullores së Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe veçanërisht Rregullores së Programit të Studimit. Informacioni është i publikuar edhe në faqen web të AU. Gjithashtu referuar faqes web të IAL, janë përgatitur manual dhe udhëzues për informimin e studentëve mbi këto aspekte (përgatitur nga Zyra e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve në “Albanian University”). <i>GVJ konstaton që materialet rreth udhëzuesve dhe manualeve për studentët, të publikuara në faqen web të AU, janë të disa viteve më parë, prandaj GVJ rekomandon rishikimin dhe përditësimin e tyre.</i> <i>(Evidencë S I.3; S I.4; S I.5; S II.1)</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/udhezuesi-i-karrieres/

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

56

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	https://albanianuniversity.edu.al/sq/manuali-i-studenteve/ Referuar Rregullores së Programit të Studimit dhe veçanërisht Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve, GVJ konstaton se studentit i ofrohet mundësia për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, si brenda Institucionit ashtu edhe nga IAL të ndryshme, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, dhe kjo procedurë realizohet vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë për transferimet, si edhe në rregulloren e programit të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. <i>(Evidencë S I.3; S I.4; S I.5; S II.1; S II.4)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët, në AU, informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin studimit nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit dhe Rregullores së Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Në orën e parë të fillimit të procesit mësimor për secilën lëndë, studentëve ju ofrohet informacion nga pedagogu lëndës për syllabusin lëndor, detyrimeve për t'u përmbushur si edhe mënyrën e vlerësimit. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor të lëndës vlerësohet me një sistem pikëzimi 100 pikësh, i cili konvertohet në notë në procesverbalin përfundimtar. Bazuar në rregulloren e mësipërme, si edhe nga verifikimi syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi dijeve të studentëve kryhet në mënyrë të ndryshme për lëndët e kurrikulës, duke i'u referuar specifikës dhe përmbajtjes së komponentëve lëndor (leksion, seminar, laborator, praktika, detyra kursi). Vlerësimi përfundimtar i dijeve të studentëve bazohet në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë vlerësimit dhe kontrollit të vazhdueshëm (40%) dhe pikëve në provimin final (60%), e cila është maksimalisht 100 pikë. Kuadri rregullator i brendshëm në nivel institucional, dhe njësie bazë dhe vetë rregulloren e këtij programi përcaktojnë se nëse studenti nuk frekuenton 75% të leksioneve dhe seminareve, si edhe 100% të seancave laboratorike atëhere ai nuk pranohet në sesionin e parë të provimit, shlyerja në vazhdimësi e detyrimeve të frekuentimit realizohet sipas specifikave të detajuara në rregulloren e programit studimor. <i>(Evidencë S I.4; S I.5; S II.1; S II.5; Evidencë Anex Tab. nr. 15)</i>

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Procedura dhe mënyra e punimit të temës së diplomës me kriteret e detyrueshme për realizimin me sukses të saj janë parashikuar në mënyrë të detajuar në dokumentin referuar procedurave dhe manualit të diplomës. AU publikon informacione të vazhdueshme për studentët diplomantë lidhur me mënyrën e punimit të tezës së diplomës, duke përfshirë jo vetëm formatin e shkrimit por edhe udhëzime në lidhje me organizimin e përgjithshëm të saj. Studenti fillimisht, plotëson me dëshirën e tij fushën ku ai dëshiron të punojë temën e diplomës dhe në mbledhjen e njësisë bazë caktohet udhëheqësi i cili i përshtatet fushës së përzgjedhur nga studentit. Temat e diplomës miratohen nga Dekani i Fakultetit dhe formati i printuar dorëzohet disa javë para mbrojtjes së tyre. <i>(Evidencë S II.1; S III.4)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se në çdo vit akademik, përmes Zyrës së Zhvillimit të Karrierës, AU merr pjesë në aktivitete si: fushata informimi, afishim të informacionit në mjediset AU, vizita në institucione ku maturanët dhe studentët e ardhshëm njihen me programet e studimit, ambjentet dhe mjediset, tarifat shkollimit dhe të gjitha mundësitë që ofron AU. Gjithashtu në ndihmë vjen edhe faqja zyrtare web e AU në të cilën janë të publikuara informacione të përgjithshme mbi programet e studimit dhe njoftime të tjera informuese për studentët e ardhshëm. <i>(Evidencë S V.3)</i> https://albanianuniversity.edu.al			
Konkluzione	<i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre, transferimit të studimeve si edhe njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit, praktikës profesionale dhe përmbylljes së tyre me tezë diplome. Përpara fillimit të çdo viti akademik IAL ofron informacion për të interesuarit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” informohen në fillim të studimeve nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi, Zyra e Koordinimit dhe Mbeshtetjes së Studentëve, si edhe nga veprimtaria e tutoriatit i cili duke patur një kontakt të ngushtë me kurset e studentëve është në gjendje të japë gjithë informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit dhe kohëzgjatjes së ciklit të studimit. <i>(Evidencë S II.1)</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-koordinimit-dhe-mbeshtetjes-ndaj-studentit/
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e këtij program studimi marrin informacion më të detajuar për të gjithë elementët lidhur me modulet e kurrikulës së programit gjatë prezantimit të orës së parë të mësimit nga pedagogët e lëndëve. Informacion të detajuar, gjithashtu ata mund të gjejnë edhe në faqen web të AU, portalin e studentëve, apo afishimeve të informacionit në ambjentet e AU. <i>(Evidencë S II.5)</i> https://albanianuniversity.edu.al
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Gjatë vizitës në institucion me përfaqësuesit e Zyrës së Këshillimit të Karrierës, rezultoi se kjo strukturë kujdese kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit. Kjo zyrë ka në fokus ofrimin e këshillimit për studentët për t’i përgatitur për të aplikuar për punësim, si edhe organizon evente në funksion të informimit për punësim rreth marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara nga AU me institucione të ndryshme publike dhe jopublike në shërbim të këtij qëllimi, apo takime me rrjetin Alumni etj. Gjithashtu informacion rreth mundësive të punësimit ofrohet edhe nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimor dhe nga vetë Departamenti Farmacisë. <i>(Evidencë Anex Tab. nr. 23; Evidencë S II. 11)</i>

	https://albanianuniversity.edu.al/sq/performanca-akademike-e-studenteve-te-diplomuar-dhe-niveli-i-punesimit-te-tyre-ne-tregun-perkates-te-punes/			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstaton se, pedagogët e departamentit farmacistë, në javën e parë të fillimit të procesit mësimor dhe jo vetëm, pedagogët e angazhuar në programin studimor, sekretaria mësimore, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Studentore luajnë një rol kyç në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikës, infrastrukturës dhe gjithë shërbimeve të tjera në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Faqja web e AU luan gjithashtu një rol thelbësor në ofrimin dhe përditësimin e informacionit në lidhje me element të rëndësishëm të procesit mësimor. https://albanianuniversity.edu.al https://albanianuniversity.edu.al/sq/kalendari-akademik-2/			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nëpërmjet faqes web të AU dhe hapësirës së dedikuar në portalin studentor, studentët e këtij program studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me stukturën e vitit akademik, orarin mësimor, të marrin informacion rreth vlerësimit të vazhduar dhe atë përfundimtar sipas lëndëve të frekuentuara etj, si edhe të informohen mbi infrastrukturën apo aktivitete në nivel institucioni, fakulteti apo njësie bazë. https://albanianuniversity.edu.al			
Konkluzione	Studentët informohen në fillim të vitit akademik, si edhe gjatë gjithë periudhës së studimeve për të gjithë detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor si edhe elementët ndihmës në funksion të tij. Zyra e Këshillimit të Karrierës, si edhe pedagogët e angazhuar në programin studimit ofrojnë informacion për mundësitë e punësimit të studentëve. Studentët janë të përditësuar dhe kanë akses si fizik ashtu edhe online mbi informacionet në lidhje me procesin mësimor, infrastrukturën, logjistikën dhe element të tjerë mbështetës të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Mbi bazën e dokumentave shoqëruese dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Sekretaria Mësimore në AU është njësi që kujdeset për mbajtjen e të dhënave dhe përpunimin statistikor vjetor për numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si edhe të transferuar në apo nga ky program studimi. Sekretaria mësimore mbledh, regjistron, dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të studimeve dhe diplomimin e tyre. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ konstatoi se dy nga regjistrat që u vendosën në dispozicion të GVJ, Regjistri Themeltar dhe Regjistri i Arritjeve Akademike ishin të formatuara sipas standarteve shtetërore, ndërsa Regjistri i Lëshimit të Diplomave nuk u vendos në dispozicion të GVJ. <i>Gjatë shqyrtimit të regjistrat të arritjeve akademike u konstatua që kishte faqe të lëna bosh, emra studentësh poshtë vijës së kuqe të cilët sipas konfirmimit të sekretarisë mësimore janë studentë që janë klasifikuar si përsëritës, apo edhe korrigjime në nota dhe numra matrikullimi. Rastet e sipërpërmendura janë të konstatuara dhe të shoqëruara me procesverbal nënshkruar nga Kryesekretari dhe nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore me argumentin e gabimeve njerëzore dhe paqartësisë në mënyrën e plotësimit të formatit të ri të regjistrave.</i> Pranë sekretarisë depozitohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Në vijim paraqiten të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për periudhën 2019-2024:																				
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<table><tr><th>Viti akademik</th><th>Të regjistruar për herë të parë</th><th>Transferime</th><th>Të diplomuar</th></tr><tr><td>2019-2020</td><td>22</td><td>18</td><td>74</td></tr><tr><td>2020-2021</td><td>31</td><td>17</td><td>69</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>50</td><td>15</td><td>51</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>39</td><td>26</td><td>36</td></tr></table>	Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Transferime	Të diplomuar	2019-2020	22	18	74	2020-2021	31	17	69	2021-2022	50	15	51	2022-2023	39	26	36
Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Transferime	Të diplomuar																		
2019-2020	22	18	74																		
2020-2021	31	17	69																		
2021-2022	50	15	51																		
2022-2023	39	26	36																		

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

61

	2023-2024	44	24	-
	Referuar dokumentacionit në RVB dhe atij shtesë, numri total i të diplomuarve në këtë program studimi është 230 studentë nga të cilët 196 student janë të punësuar në përputhje me diplomën. <i>(Evidencë S III.3; Evidencë Anex Tab. nr. 21,23)</i> <i>(Evidencë shtesë Procesverbal për gabime në regjistra)</i>			
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të AU. Pranë sekretarisë mësimore informacioni ruhet në formatin letër (hardcopy) dhe në formatin elektronik (softcopy). Të dy mënyrat e ruajtjes lehtësojnë monitorimin dhe kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar. <i>(Evidencë S III.3)</i> https://au.pitagora.rash.al			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Referuar RVB, Statutit AU dhe Rregullores së Fakultetit të Shkencave Mjekësore, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregulloret përkatëse për njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit. Lidhur me kontrollin periodik të strukturave që merren me menaxhimin apo vlerësimin periodik të saktësisë së informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtaritë akademike të tyre u konstatua paraqitja e tyre në raportin vjetor institucional dhe nga Njësia e Sigurimit Brendshëm Cilësisë (NJSBC). <i>(Evidencë shtesë 5)</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se pjesë e raportit vjetor të Departamentit të Farmacisë ishte edhe statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar, kalueshmërinë në lëndë sipas viteve, si edhe numrin e studentëve të diplomuar në programin e studimit që ofrohet nga ky department. <i>(Evidencë S III.1)</i>			

Konkluzione	<i>AU mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si edhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke siguruar respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Departamenti i Farmacisë përgjegjës për këtë program studimi analizon në fund të vitit akademik të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe dalje, punësimin e tyre duke konkluduar edhe rekomandimet në funksion të rritjes së cilësisë së programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, informacionin plotësues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se AU ka mundur angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në strukturat vendimmarrëse të institucionit, në Senatin Akademik, Këshillin Etikës, NJSBC, në Komisionet e Përhershme si edhe pranë Grupit të Vlerësimit Brendshëm të këtij programi studimi. GVJ evidentoi që studentët kanë Këshillin Studentor, si organ i bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” si edhe Statutit të AU, neni 63, pika 1 dhe 2). <i>(Evidencë S I.1; S I.3; S V.4; Evidencë Anex Tab. nr. 24, RVB - AU)</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me	GVJ konstatoi se studentët gjithashtu, përfshihen në procese këshilluese apo vlerësuese përmes sistemit të pyetësorëve dhe procedurave me fokus grupe studentët, për vlerësimin e stafit akademik, lëndët sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin si edhe për gjithë procesin mësimor në tërësi. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve realizohet nga NJSBC dhe përfundon me hartimin e rezultateve të vlerësimit të cilat më pas njësisia bazë duke i marrë në konsideratë, diskuton në mbledhje departamenti

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	problematikat e ngritura dhe reflekton duke marrë vendime mbi përmirësimin e syllabuseve, përmirësimin e metodave të mësimdhënies si edhe ndryshimeve kurrikulare. Gjithashtu Departamenti Farmacisë, përgjegjës për këtë program studimi mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe koordinatorit të programit të studimit. <i>(Evidencë S VI.1; S VI.2; Evidencë shitesë 2, 2.1, 13, 13.1)</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstaton se në statutin e AU dhe në rregulloret përkatëse institucionale dhe në atë të programit të studimit, është e evidentuar dhënia e të drejtës studentëve për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e provimit nga ana e pedagogut përgjegjës të lëndës. <i>(Evidencë S I.4; S I.5; S II.1; S V.4)</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	<i>Institucioni ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, NJSBC, Komisionet e Përhershme si edhe në GVB në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të institucionit. GVJ konstatoi se institucioni përdor edhe pyetësorin për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe personelit akademik sipas lëndëve dhe programeve që ata ndjekin. Kuadri rregullator i AU parashikon të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe/ose vlerësimin në provim.</i>			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

64

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në Rregulloren e AU (neni 18 dhe 37), Sekretaria Mësimore, Zyra e Koordinimit dhe e Mbështetjes për Studentët, Zyra e Këshillimit të Karrierës janë përcaktuar si njësi mbështetëse të institucionit në shërbim edhe të informimit të studentëve. Gjithashtu Koordinator i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” së bashku me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi vazhdimisht informojnë studentët mbi të gjitha aktivitetet që lidhen me procesin mësimor. <i>(Evidencë S I.3; S I.5; S II.1; S III.3)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Departamenti i Farmacisë, njësia bazë që mbulon këtë program studimi është përgjegjës për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve nëpërmjet njësive të sipërpërmendura, por edhe stafit akademik të saj. Koordinator i programit të studimit, luan një rol kyç dhe të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij program studimi. Njëkohësisht, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët janë njësitë përgjegjëse për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe aktivitetin shkencor. <i>(Evidencë S I.3; S I.4; S I.9; S II.1)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në takimin me përfaqësueset e Zyrës së Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Marrdhëniet me Jashtë gjatë vizitës në institucion, GJVJ konstaton se kjo zyrë u shpërndan studentëve (përfshirë edhe studentët e degës së farmacisë) një “Udhëzues për Zhvillimin e Karrierës” në çdo fillim viti akademik, duke dhënë këshilla konkrete dhe bashkëkohore mbi krijimin e mundësive për një zgjedhje më të lehtë të karrierës. Personi përgjegjës për këshillimin e karrierës dhe jetës studentore përmes takimeve të drejtpërdrejta apo komunikimeve me email u jep studentëve informacion rreth planeve mësimore, kurrikulave dhe procesit të diplomimit, orienton studentët për të hyrë në tregun e punës, në bashkëpunim me departamentin farmacisë ndihmon në gjetjen e vendeve për realizimin e praktikave mësimore bazuar edhe në marrëveshjet e lidhura nga departamenti/IAL si edhe mban të dhëna për punësimin e të diplomuarve.

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjithashtu, Zyra e Këshillimit të Karrierës ka për detyrë të mbështesë studentët e diplomuar në mënyrë që ata të orientohen dhe të përshtaten më së miri me tregun e punës. Për këtë qëllim zyra mbledh të dhëna për të diplomuarit përmes pyetësorit për studentët alumni (i cili gjendet në faqen web të AU), ndjek integrimin e tyre në tregun e punës dhe mban kontakte me studentët e diplomuar me qëllim bashkëpunimin për interesa të përbashkëta. <i>(Evidencë shtesë 1)</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/pyetesor-per-alumni/			
Konkluzione	Në dispozicion të informimit të studentëve janë Sekretaria Mësimore, Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve si edhe Koordinator i Programit të Studimit. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Departamenti i Farmacisë u ofrojnë studentëve informacion dhe këshillim mbi procesin mësimor, praktikat profesionale, si edhe orientim në tregun e punës. GVJ evidentoi që Zyra e Këshillimit të Karrierës, Alumni mbledh të dhëna për të diplomuarit dhe ndjek integrimin e tyre në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, GVJ konstaton se IAL ka në fokus të politikave dhe objektivave të tij zhvillimin e metodave moderne interaktive të mësimdhënies të cilat inkurajojnë të menduarit kritik duke e vendosur studentin në qendër të mësimdhënies. Synimi kryesor është që teknikat e mësimdhënies

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

66

mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	dhe përmbajtja e kurrikulave të përshtaten me nevojat që dikton tregu i punës si edhe të riorganizohen drejt dixhitalizimit, ndërdisiplinaritetit dhe të jenë sa më aplikative (Strategjia AU 2023-2028 dhe Strategjia NJSBC 2022-2025). Analiza e syllabuseve tregon se në lëndë të veçanta janë integruar elementë inovative në mësimdhënie, të lidhur me format e kontrollit të dijeve, formatet e ligjërimit etj. <i>(Evidencë S I.2; S I.3; S II.5; S III.2; S VI.6)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të RVB dhe si edhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se IAL e konsideron Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin si edhe Njësine bazë, Departamentin Farmacisë si struktura përgjegjëse për zhvillimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe atij ndihmës-akademik. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. IAL bën monitorim dhe vlerësim periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të tillë si anketa dhe pyetësorë. Stafi akademik plotëson një formular vetvlerësimi në fund të vitit akademik, gjithashtu përgjegjësi departamentit plotëson formularin e vlerësimit për stafin akademik. <i>(Evidencë S VI.1; S VI.2; Evidencë shtesë 12)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Në fund të çdo semestri, përpara sesionit të provimeve, studentëve u vihet në dispozicion nga IAL pyetësori për vlerësimin e formave të mësimdhënies, kurrikulës, mënyrën e vlerësimit të dijeve, përfshirë edhe mundësinë e ankimimit. Referuar informacionit të përcjellë në RVB, GVJ konstatoi se në përbërje të NJSBC ka edhe përfaqësues nga studentët, gjithashtu edhe GVB për programin që riakreditohet ka në përbërjen e tij një student. Së fundmi konstatohet se studentët përfshihen në vlerësimin periodik të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet aktiviteteve të posaçme që kanë si qëllim evidentimin e ecurisë së vitit akademik përkatës. <i>(Evidencë S.VI.2; Evidencë shtesë 5; Evidencë Anex Tab. nr. 24)</i>

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se NJSBC si strukturë përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie: - Harton një raport vjetor, në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies, përfshirë edhe rezultatet e përpunimit të pyetësorëve si edhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë. - Raporti vjetor fillimisht paraqitet pranë Komisionit të Vlerësimit Institucional, i cili më pas e përcjell tek Senati Akademik për ta përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së radhës së tij. - Rezultatet e raportit të përpunuara përcillen në Departament, ku rastet specifike apo shqetësuese diskutohen në mënyrë konfidenciale me personelin akademik me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>(Evidencë S VI.1; S VI.2; Evidencë shtesë 5)</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referuar vizitës në institucion dhe të dhënave të mbledhura gjatë takimeve të ndryshme, GVJ konstaton gadishmërinë e IAL për mbështetje financiare për stafin akademik si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor, ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesëmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështetja financiare për të botuar artikuj në revista me faktor impakti të lartë, monografi etj). <i>(Evidencë S.III.6; Evidencë shtesë 7)</i>			
Konkluzione	<i>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, veçanërisht NJSBC dhe Departamenti Farmacisë vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik, raportojnë në instancat përkatëse sipas rregullores së AU. Studentët përfshihen në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit të cilësisë, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, pjesëmarrjes në komisionet e përhershme si edhe këshillit studentor. Institucioni është i angazhuar në nxitjen e personelit akademik në funksion të mësimdhënies dhe kualifikimit shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në IAL, GVI konstaton se statuti i AU (Kreu VII, neni 66, 67 dhe 68) dhe rregullorja e AU (neni 13 dhe 14) përcaktojnë qartë se institucioni harton politika dhe procedura në funksion të sigurimit të cilësisë. Në institucion është krijuar dhe është aktive NJSBC, njësia që përcakton procedurat dhe metodat për sigurimin e cilësisë të cilat janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë si edhe me manualin “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit, 2017”. <i>(Evidencë S I.1; S I, 3; S VI.1)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shtesë, në AU, NJSBC funksionon që nga viti 2009-2010. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në AU, është ngritur me Vendim Senati Akademik, nr. 178 dt. 23.07.2010 si edhe në përputhje me Ligjin 80/2015. Me Vendim nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22.12.2016 është ngritur Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin Institucional, pjesë e së cilit është edhe një student. Prej shtatorit të vitit 2016, në mbështetje të cilësisë, në AU, funksionon edhe grupi i sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë, ngritur me Vendim Senati Akademik nr. 157/3 dt. 08.09.2016, anëtarët e të cilëve përditësohen çdo vit. Institucioni i jep një rëndësi të veçantë sigurimit të cilësisë në çdo instancë akademike, shkencore dhe administrative. Për këtë arsye politikat e sigurimit të cilësisë institucionale paraqiten jo vetëm në Strategjinë Institucionale, por edhe në Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Në kuadër të realizimit të këtij objekti, NJSBC bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm: një konsulent juridik dhe një konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. <i>(Evidencë S VI.3; S VI.4; S VI.5; S VI.6; S VI.7; S VI.8)</i>

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	IAL dhe programi studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” i janë nënshtruar procesit të akreditimit të jashtëm në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve të kuadrit rregullator në fuqi. Akreditimi institucional i AU është realizuar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 55, dt 26.05.2023. Ndërsa programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 18, dt. 02.03.2019. <i>Evidencë nga web ASCAL</i> https://www.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara https://www.ascal.al/sq/akreditimi/programe-te-akredituara			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion konkludon se NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues cilësor dhe sasior në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitura dërgohen në strukturat sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe veçanërisht departamenti përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet dhe masat përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit të studimit. Institucioni bën promovime nxitëse për arritje më të mira në programin studimor përmes granteve të mbështetjes financiare për publikime në revista të indeksuara, pjesëmarrje në konferenca shkencore etj. <i>(Evidencë S VI.1; S VI.2; Evidencë shtesë 5, 7, 13, 13.1)</i>			
Konkluzione	Në AU sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional dhe njësie bazë. Institucioni harton politika dhe procedura të sigurimit të cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregullatore. NJSBC përgatit raporte me tregues sasior dhe cilësor dhe ua dërgon strukturave përkatëse, të cilat marrin vendime në funksion të përmirësimit të cilësisë. Institucioni bën promovime nxitëse për arritje më të mira në programin studimor përmes granteve të mbështetjes financiare për publikime në revista të indeksuara, pjesëmarrje në konferenca shkencore etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë dhe në atë të marrë gjatë takimeve në IAL, GVJ konstaton përdorimin e pyetësorëve të studentëve si mekanizma për të siguruar informacionin e nevojshëm mbi ecurinë e programit të studimit dhe lëndëve, cilësinë e mësimdhënies, angazhimin e personelit akademik, infrastrukturën dhe logjistikën e vënë në dispozicion të studentëve. NJSBC realizon përpunimin dhe analizën e pyetësorëve, më pas rezultatet u komunikohen strukturave drejtuese të AU, sipas rregulloreve përkatëse, përmes raportit vjetor të veprimtarisë së AU. GVJ konstaton se raportet paraqesin informacion të aktivitetit (për çdo njësi kryesore) akademik dhe shkencor të njësive të institucionit dhe përfshijnë një analizë të arritjeve/pikave të dobëta apo plan masash për përmirësim. Gjithashtu në nivel njësie bazë, pranë Departamentit të Farmacisë përgjegjës për këtë program studimor, miratohen çdo fillim viti akademik syllabuset lëndore të përditësuara referuar sugjerimeve të stafit akademik dhe orjentimit të nevojave të tregut. Në fund të çdo viti akademik, njësia bazë, harton edhe raportin përfundimtar, i cili përmban të gjithë komponentët e vlerësimit të procesit mësimor dhe shkencor.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	<i>(Evidencë S. II.7; S III.1; S VI. 12; Evidencë shtesë 5)</i>

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	“Albanian University” për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, si më poshtë: pyetësorë të studentëve (2 herë në vit), fokus grupe (në muajin janar) mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës etj., takime me studentët, raporte vetvlerësimi nga pedagogët, raporte vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit, rishikimi vjetor i syllabuseve, organizimi i leksioneve të hapura, vëzhgime në auditor, analiza në mbledhjet e departamentit mbi kalueshmëritë sipas lëndëve, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, testime lokale apo të standartizuara etj. Për më tepër, në nivel departamenti, tutoriati vazhdimisht nxit studentët të japin opinionet dhe sugjerimet e tyre për lëndët dhe programin në tërësi, metodat e mësimdhënies etj., duke mundësuar vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij. <i>GVJ rekomandon zgjerimin e përfshirjes së rrjetit ALUMNI në politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu, GVJ rekomandon zgjerimin e këtyre teknikave duke përdorur edhe intervista me përfaqësues të bizneseve dhe subjekteve farmaceutike pranë të cilave studentët kryejnë praktika mësimore, opinionet e të cilëve përbëjnë një komponent të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës.</i> <i>(Evidencë S VI.1; Evidencë shtesë 5)</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	

Konkluzione	Institucioni siguron një sistem raportimi i cili përfshin tregues cilësor dhe sasior, bazuar në përpunimin e pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si edhe kurrikulën e programit të studimit. Rezultatet e procesit bëhen të njohura në nivel njësie kryesore dhe bazë, më pas rezultatet bëhen me dije për stafin akademik në mbledhje departamenti. Institucioni në kuadër të vlerësimit të cilësisë përdor një sërë metodash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, megjithatë GVJ sugjeron përfshirjen me aktive të rrjetit ALUMNI si edhe të intervistave të përfaqësuesve të subjekteve farmaceutike dhe institucioneve të tjera në funksion të përmirësimit të kurrikulës së këtij program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Referuar informacionit të përshkruar në RVB dhe atij shtesë, GVJ konstaton se kuadri rregullator i AU, si Statuti, Rregullorja e Organizimit Institucional, në garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit parashikon dhe siguron përfshirjen e strukturave si organet drejtuese të institucionit, Senatit Akademik, Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Këshillit Studentor dhe Departamentit të Farmacisë, përgjegjës për programin e studimit. Në Rregulloret e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, të Departamentit të Farmacisë dhe në Rregulloren e NJSBC evidentohen detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave sipas roleve që mbulojnë lidhur me sigurimin e cilësisë, në programet e studimit. Gjithashtu, prej shtatorit të vitit 2016, AU ka ngritur strukturë për sigurimin e cilësisë në nivel njësie bazë, e cila monitoron, evidenton dhe merr masa për përmirësim të vazhdueshëm të procesit mësimor.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	(Evidencë S I.1; S I.3; S I.4; S I.5; S VI.1)
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së	GVJ vlerëson se IAL garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në procesin e vlerësimit dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

73

programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	sigurimit të cilësisë së programit të studimit, duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Gjatë vizitës së zhvilluar në AU, me përfaqësuesen e NJSBC dhe personelin akademik të këtij program studimi, GVJ konstaton angazhimin e tyre në procesin e vlerësimit të brendshëm përmes përditësimit dhe diskutimit të raporteve të vlerësimit të bëra në mbledhjet e departamentit, si edhe përfshirjes së një personeli akademik nga departamenti si anëtar i NJSBC dhe njësisë së sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë. Në përbërje të NJSBC merr pjesë edhe një student, i propozuar nga Këshilli Studentor.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se procesi i vlerësimit të brendshëm është gjithëpërfshirës dhe se pyetësorët dhe instrumentet e përdorura në këtë proces nuk çenojnë lirinë akademike dhe integritetin akademik të pjesëmarrësve. Strukturat e vlerësimit të brendshëm kujdesen, që të shmangin çdo lloj diskriminimi duke ruajtur privatësinë e informacionit dhe të rezultateve të marra. <i>(Evidenca S I.4; S I.5; S VI.11; Evidencë shtesë 5)</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në dokumentacionin shtesë, GVJ konstaton se AU dhe departamenti Farmacisë ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe subjekte private (ku studentët kryejnë edhe praktikën profesionale mësimore në vitin e pestë të ciklit akademik), nëpërmjet të cilave ekziston mundësia e përfitimit në kuadër të konsultimeve apo sugjerimeve për rritjen e cilësisë së programit/eve të studimit që ofron. Gjithsesi, <i>GVJ sugjeron që pjesë aktive në procesin e vlerësimit të bëhen edhe bashkëpunëtorë të jashtëm të IAL, veçanërisht përfaqësues të rrjetit ALUMNI dhe ekspertë të fushës.</i> Gjithashtu, institucioni dhe Departamenti i Farmacisë, përgjegjës për programin e studimit organizon leksione të hapura me ekspertë nga fusha të ndryshme apo konferenca shkencore të organizuara nga vetë departamenti, të cilat garantojnë një përmirësim në vazhdimësi të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidencë S I.12; S III.5; S V.5)</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë në nivel institucioni dhe njësie bazë, të cilat kanë në përbërje të tyre personel akademik dhe studentë. Përzgjedhja e anëtarëve të</i>

	strukturave të vlerësimit të cilësisë bëhet në respekt të integritetit akademik, duke shmangur diskriminimin apo pabarazinë. Anëtarët e njësive të sigurimit të cilësisë kanë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. GVJ sugjeron që pjesë aktive në procesin e vlerësimit të bëhen edhe bashkëpunëtorë të jashtëm të IAL, veçanërisht përfaqësues të rrjetit ALUMNI dhe ekspertë të fushës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstaton se institucioni e sheh sigurimin e brendshëm të cilësisë si pjesë përbërëse të strategjisë së zhvillimit të tij dhe ka hartuar një politikë apo strategji të veçantë për të. GVJ konstaton se raportet vjetore janë të publikuara në faqen web të AU, ndërsa raportet e NJSBC nuk janë bërë publike. Por në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se këto raporte i komunikohen të gjitha strukturave drejtuese dhe diskutohen më gjërësisht në njësinë bazë.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Informacioni i paraqitur në këto raporte respekton lirinë dhe etikën akademike, si edhe ruan privatësinë e informacionit në përputhje të plotë me legjislacionin për të dhënat personale. (Evidencë S I.2; S VI.1; S VI.6; S VI.11)
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Duke i'u referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij plotësues, GVJ konstaton se raportet e vlerësimit të NJSBC (raporti vjetor dhe pyetësorët e studentëve) realizojnë një paraqitje të detajuar përshkruese të veprimtarisë së IAL. Në përfundim të raportit paraqitet një analizë konkrete, analiza SWOT, ku mundësohet nxjerrja e përfundimeve të bazuara dhe hartimi i një plani masash konkrete, nga njësia kryesore, për përmirësimin e problematikave të evidentuara në raport.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

75

efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Më pas këto raporte bëhen pjesë e diskutimeve dhe analizave vjetore në nivel institucioni, njësie kryesore apo njësie bazë. Në mbledhjen e njësisë bazë, personeli akademik diskuton dhe analizon ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me studentët, në funksion të përmirësimit të cilësisë së procesit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<i>(Evidencë S VI.1; S VI.12; Evidencë shitesë 5)</i>			
Konkluzione	<i>Raportet vjetore të NJSBC nuk janë të publikuara në faqen zyrtare web të IAL. Në përfundim raportet përmbajnë një analizë konkrete, që nxjerr në pah pikat e forta dhe të dobëta dhe mundëson nxjerrjen e përfundimeve të bazuara si edhe hartimin e një plani konkret masash, në nivel njësie kryesore, për përmirësimin e problematikave të evidentuara në raport.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave” (PI)
në “Farmaci” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Albanian University”**

Pikat e forta dhe afirmime

1. Infrastruktura e përshtatshme sipas normativave dhe me një funksionalitet optimal për zhvillimin normal të procesit mësimor (seancave laboratorike dhe praktikave mësimore etj) dhe kërkimit shkencor.
2. Rritje e kualifikimit me tituj dhe grada e stafit akademik efektiv duke siguruar përmbushjen e kriterëve ligjore dhe rritje të cilësisë së procesit mësimdhënies dhe kërkimor- shkencor.
3. Bashkëpunim dhe pjesëmarrje e ndërsjellë e trupës akademike me të gjitha hallkat e Departamentit të Farmacisë dhe FSHM për ecurinë e procesit të mësimdhënies dhe rritjes cilësore të tij.
4. Realizimi dhe zbatimi i një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë vendas dhe të huaja dhe atyre kërkimore shkencore.

Pika të dobta

1. Mungesa e mënyrave alternative të financimit, mbështetja kryesisht në tarifat e studimit si burim financimi do të ishte e pamjaftueshme në kohë, duke patur parasysh rënien e numrit të studentëve që ka ndodhur në këto 4 vitet e fundit.
2. Numri i ulët i mobilitetit si nga ana e stafit akademik ashtu edhe nga studentët.
3. Titullari i lëndës jo në të gjitha rastet i përket ekspertizës apo kërkimit shkencor në përputhje me natyrën dhe veçoritë e lëndëve të ofruara.

Rekomandime

1. GVJ rekomandon rishikimin e kategorizimit të veprimtarive formuese sipas tipologjive të specifikuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 dhe respektimi në tërësi i këtij akti në lidhje me titullarët lëndor.
2. Zgjerimi i pjesëmarrjes dhe bashkëpunimeve në projekte kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e shkencave farmaceutike.
3. Nxitja dhe mbështetja e studentëve dhe stafit akademik për pjesëmarrje në programet e ndryshme ndërkombëtare të mobilitetit.
4. GVJ rekomandon përfshirjen e ALUMNI dhe partnerëve të jashtëm më shumë në në reflektimin e eksperiencës së tyre në drejtim të përmirësimit të kurrikulës së programit të studimit.



5. GVJ rekomandon diversifikimin e burimeve financiare në funksion të këtij program studimi.

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program “Master of Science” (IP) in “Pharmacy” offered by the Higher Education Institution “Albanian University”

Strengths and affirmations

1. Appropriate infrastructure according to the norms and with optimal functionality for the normal development of the teaching process (laboratory sessions and teaching practices, etc.) and scientific research.
2. Increasing the qualification with titles and ranks of effective academic staff by ensuring the fulfillment of legal criteria and increasing the quality of the teaching and scientific research process.
3. Mutual cooperation and participation of the academic staff with all links of the Department of Pharmacy and the Faculty of Pharmacy for the progress of the teaching process and its qualitative increase.
4. Realization and implementation of a series of cooperation agreements with domestic and foreign higher education institutions and scientific research institutions.

Weaknesses

1. Lack of alternative funding methods, relying mainly on tuition fees as a source of funding would be insufficient in time, considering the decline in the number of students that has occurred in the last 4 years.
2. Low mobility of both academic staff and students.
3. The head of the course does not in all cases belong to the expertise or scientific research in accordance with the nature and characteristics of the courses offered.

Recommendation

1. GVJ recommends reviewing the categorization of training activities according to the typologies specified in the Council of Ministers No. 41, dated 24.01.2018 and full compliance with this act in relation to subject holders.
2. Expanding participation and collaboration in research projects at the national and international level in the field of pharmaceutical sciences.
3. Encouraging and supporting students and academic staff to participate in various international mobility programs.
4. GVJ recommends involving ALUMNI and external partners more in reflecting their experience in improving the curriculum of the study program.



5. GVJ recommends diversifying financial resources in function of this study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X


